



Përmbajtja

Katër vjetori i Shpalljes së Republikës së Kosovës	3
Shqiptarët të bashkuar në Jubileun e 100- vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë	7
Hungaria mbështet Kosovën në procesin liberalizimit të vizave dhe të integriteteve euro-atlantike	9
Kosova ka mundësi historike për të ecur përpara	10
Kosovë – Maqedoni impulse të reja bashkëpunimi	13
Legjislatura IV	14
Përmirësime në rregulloren e Kuvendit	17
Mblidhet Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit	22
Projektligji avancon sektorin bankar në Kosovë	23
Shuhet Gjeneralmajor, Shaban Shala	25
8 Marsi - Në Kuvendin e Republikës së Kosovës	27
Alternativat e energjisë në Kosovë	29
Pyetjet Parlamentare	31
Takimet e Kryetarit të Kuvendit	34



5 Mars, 2012

E boton: Zyra për Media dhe Marrëdhënie me Publikun
Redaktoi: Petrit Subashi, Zyrtar I Lartë për Publikime

Katër vjetori i Shpalljes së Republikës së Kosovës

Kosova gjatë këtyre katër viteve të pavarësisë ka bërë hapa të mëdhenj drejt ndërtimit e konsolidimit të shtetit demokratik



Pamje nga salla

Mirënjohje për SHBA-në, BE-në dhe vendet anëtare të NATO-s

Me një Seancë Solemne, Kuvendi i Kosovës shënoi 4 –vjetorin e Ditës së Pavarësisë së Kosovës. Këtë seancë solemne e kryesoi dr. Jakup Krasniqi, ku përveç deputetëve të kësaj legjislature, të pranishëm ishin presidentja e Kosovës, Atifete Jahjaga, kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, udhëheqës tjerë të lartë të institucioneve shtetërore, kulturore e fetare, ish deputetë të legjislaturave të kaluara, si dhe përfaqësues të trupit diplomatik të akredituar në Kosovë.

Pas intonimit të himnit, fjalën e rastit para të pranishmëve e mori kryetari i Kuvendit të Kosovës z. Jakup Krasniqi i cili theksoi:- “ Shpallja e Pavarësisë së Kosovës në këtë sallë, më 17 shkurt të vitit 2008, ishte akti final historik i luftërave të pareshtura të shumë brezave për liri dhe mëvetësi shtetërore të vendit tonë ”.

Mosha e shtetit të Kosovës është e re, por ideali i popullit të tij për liri e pavarësi është i vjetër. Ky ideal frymëzoi e mobilizoi ndër dekada e shekuj bijat e bijtë më të mirë të kësaj toke, të cilët u nisën rrugës së vështirë, por të lavdishme për t'u bërë theror të lirisë.

Duke folur për kontributin që dhanë faktorët ndërkombëtarë në Pavarësinë e Kosovës, kryekuvendari Krasniqi tha:- “Gjej këtë rast

solemn t'u shpreh mirënjohje të thellë gjithë miqve tanë ndërkombëtarë, me në krye SHBA-në, BE-në dhe vendeve anëtare të NATO-s, që u vunë në anën e së drejtës dhe bënë të mundur çlirimin e shpejtë dhe pavarësimin e Kosovës, rindërtimin dhe demokratizimin e saj, afirmimin ndërkombëtar dhe njohjen nga afro nëntëdhjetë vende, anëtare të Organizatës së Kombeve të Bashkuara”.

Pasi një historiku të shkurtër të luftës së paepur dhe të vazhdueshme të Kosovës drejt Pavarësisë, kryekuvendari Krasniqi tha se Kosova gjatë këtyre katër viteve të pavarësisë ka bërë hapa të mëdhenj, drejt ndërtimit e konsolidimit të shtetit demokratik, drejt ngritjes së institucioneve shtetërore, drejt fuqizimit si subjekt ndërkombëtar dhe një zhvillimi të gjithanshëm shoqëror e ekonomik.

Vetëm duke shfrytëzuar gjithë potencialin dhe vlerat e saj, duke dyfishuar ritmet e zhvillimit ekonomik e politik, Kosova mund të hyjë denjësisht dhe kokë lartë në familjen e integruar evropiane, atje ku e ka vendin gjeografikisht, historikisht, politikisht. Në gjithë Gadishullin tonë, po bëhet zotërues ideali i integritetit dhe partneritetit midis kombeve dhe vendeve.



Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi

Pas luftës çlirimtare të Kosovës, prezencën ushtarake të NATO-s solli një realitet të ri i në Ballkan. Vendosmëria e këtij institucioni të rëndësishëm të sigurisë globale, për të mos lejuar përsëritjen e historisë tragjike, luan një rol të madh në zhdukjen e të gjitha tendencave luftënxitëse në rajonin tonë.

Në këtë përvjetor, vijoi kryekuvendari Krasniqi, vjen fuqishëm zëri i kushtimit nga vitet e rezistencës dhe nga vargu i pambarim i dëshmorëve të lirisë, vjen thirrja amanet e kryetrimt tonë legjendar, komandantit Adem Jashari, për të mbrojtur fitoret historike, për të kultivuar vlerat e

traditës së shkëlqyer të popullit tonë dhe për të përparuar e zhvilluar vendin e të parëve tanë. Ne kemi përmbyllur një betejë, atë të lavdisë dhe heroizmit për pavarësi dhe tash tha ai: -“Para nesh është beteja e madhe e zhvillimit ekonomik, e zhdukjes së varfërisë, e zhvillimit demokratik dhe e sundimit të plotë të ligjit e të rendit në shoqëri. Kosova po hyn në vitin e pestë të pavarësisë, si shtet modern evropian, demokratik dhe me respekt e njohje të gjerë ndërkombëtare. Ajo përbën sot një faktor shumë të rëndësishëm stabiliteti, paqe ndërtues dhe bashkëpunues në rajonin tonë dhe më gjerë”.

Pavarësia e Kosovës proces i pakthyesëm



Presidentja, Atifete Jahjaga

Në fjalën e rastit presidentja e Kosovës Atifete Jahjaga theksoi se ideja filozofike dhe politike për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës ishte gjithmonë ide humane, duke u bërë një rilindje në mendimin kritik, një origjinalitet në mendimin dhe në veprimin politik, një gërshetim i urtësisë si mençuri dhe përgjegjësi, një platformë largpamëse si strategji dhe si veprim e sjellje pragmatike, duke i shfrytëzuar të gjitha potencialet dhe kapacitetet, duke vënë në përdorim përvojën nga tradita e pasur, të plotësuar me idetë bashkëkohore filozofike e politike, si ndërtim i një shoqërie të re, që solli mirëkuptimin dhe përkrahjen ndërkombëtare për kauzën e drejtë të Kosovës dhe që, si asnjëherë më parë, solli frytet që sot po e gëzojmë Republikën e Kosovës shtet sovran dhe të pavarur, shoqëri demokratike të të gjithë qytetarëve, në miqësi të përditshme me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe me rrugën e qartë e prosperuese të anëtarësimit në Bashkimin Evropian dhe në NATO ”.

Në vijim ajo tha se duke vlerësuar të arriturat , kujtohen të gjithë ata që sakrifikuan, që ranë në altar të lirisë dhe që u shkrinë duke punuar për të mirën e popullit dhe të atdheut, për të qenë të lirë dhe sovranë në trojet tona, për ta ndërtuar Kosovën shtet të lirë e të pavarur. Në këtë frymë ajo tha se sot kujtohen dy figurat emblematisht, presidenti historik dr. Ibrahim Rugova dhe komandanti legjendar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, Adem Jashari, dy simbole këto udhërrëfyese për të tashmen dhe për të ardhmen tonë.

Duke i bërë një vështrim ecjes së Kosovës a drejt pavarësisë znj. Jahjaga tha:” Duke e nderuar të kaluarën tonë e nderojmë sakrificën, e nderojmë edhe të tashmen dhe të ardhshmen tonë, sepse

programi politik rreth të cilit u bashkuam ishte i drejtë, human, largpamës, i bazuar në traditat më të mira të popullit tonë, në vlerat civilizuese evropiane, duke na përcaktuar fuqishëm në familjen e popujve të Evropës. Në këtë rrugë ne nuk ishim vetëm, patëm përkrahjen e pakursyer të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, të vendeve të Bashkimit Evropian dhe të NATO-s, që bëri intervenimin ushtarak humanitar për të shpëtuar një popull. Për këtë, Pavarësia e Kosovës është proces i pakthyeshem dhe nuk ka alternativë. Ne jemi faktor paqeje dhe stabiliteti në rajon dhe më gjerë, që zhvillojmë marrëdhënie të mira bilaterale dhe fqinjësore, duke dhënë një shembull të mirë të bashkëpunimit dhe të respektit të ndërsjellë”, theksoi ajo..

Ajo në vazhdim tha se Kosova e ka ndërtuar subjektivitetin e vet ndërkombëtar dhe përfaqësohet dhe do të përfaqësohet e barabartë e me reciprocitet të plotë. Republika e Kosovës është e ndërtuar në parimin qytetar, me liri dhe të drejta të barabarta për të gjithë njerëzit. Të gjitha etnitë e Kosovës i gëzojnë të drejtat e tyre të plota kombëtare, pa marrë parasysh numrin e tyre. Kjo është vlerë e jona e ndërtuar tradicionalisht, duke respektuar dhe nderuar njëri-tjetrin.

Qytetarët dhe subjektet politike të Kosovës u dëshmuar për tolerancën dhe mirëkuptimin për respektimin e rregullave dhe të ligjit, duke ndërtuar koalicione qeverisëse efikase, duke pasur opozitë konstruktive dhe duke ndërtuar kohezion dhe unitet, duke i vënë në funksion të proceseve demokratike dhe shtetndërtuese, tha presidentja Jahjaga.

17 Shkurti i 2008-s - Ngjarja më kulmore e Kosovës dhe e qytetarëve të saj



Kryeministri Hashim Thaçi

Duke iu drejtuar të pranishmëve kryeministri i Kosovës, Hashim Thaçi, theksoi se 17 shkurti i vitit 2008, është ngjarja më kulmore historike për Kosovën dhe qytetarët e saj. “Ëndrrën bashkërisht e bëmë realitet”. Për të mbërritur deri te festa e madhe e pavarësisë së Kosovës, të gjithë ne së bashku punuam dhe sakrifikuam shumë. Sot kujtojmë presidentin Rugova, komandantin Adem

Jashari, gjithë komandantët, ushtarët, luftëtarët dhe heronjtë e Lirisë së Kosovës. Vizionin tonë të përbashkët universal për liri dhe demokraci të atdheut tonë, e realizuam bashkërisht, me unitet të qëndrueshëm politik dhe qytetar.

Republika e Kosovës është një tregim i suksesshëm me të cilin krenohemi të gjithë ne edhe miqtë tanë.

Në vitin e katërt të pavarësisë, Kosova ka shënuar suksese të njëpasnjëshme në rrafshin politik, diplomatik, dhe atë të zhvillimit ekonomik. Ne të gjithë së bashku ndihemi krenar, ashtu si e arritëm pavarësinë e vendit tonë, bashkërisht po punojmë edhe sot, çdo ditë për zhvillimin dhe integrimin e Republikës sonë në institucionet euro-atlantike”.

Në vijim kryeministri Thaçi tha se Bashkimi Evropian nuk është vetëm mekanizëm politik, por mbi të gjitha është bashkim i sistemit të vlerave. Po kështu shoqëria dhe shteti i Kosovës synojnë po ato vlera, po atë vizion, ndërtimin e Kosovës Evropiane. Secili qytetarë i Kosovës duhet të ndihet mirë dhe krenar për kontributin e tij, në realizimin e këtij vizioni.



Pamje nga salla

Viti 2012 është vit i përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, si shenjë e arritjes së standardeve demokratike. “Institucionet ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë kanë mbështetur fuqishëm agjendën që çon drejt kësaj përmbylljeje. Prandaj sot, shfrytëzoj rastin për t'i falënderuar për bashkëpunim dhe kontributin e tyre në forcimin e shtetit të Kosovës. Falënderojmë shtetet anëtare të Grupit Ndërkombëtare Drejtues, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, NATO-n dhe të gjitha institucionet tjera që e mbështesin vendin tonë”, theksoi ai.

Duke folur për të arriturat e vendit në zhvillimin e gjithanshëm, kryeministri Thaçi vlerësoi përkushtimin e vazhdueshëm institucional, me filozofinë e qeverisjes së mirë dhe të përgjegjshme, ndaj brenda katër vjetësh u shënuan zhvillime të rëndësishme në Kosovë. U krijuan më shumë vende të reja të punës, e përmirësua infrastruktura e përgjithshme kudo në Kosovë. Një pjesë e autostradës moderne Vërmicë-Merdar, duke përbushur kriteret më të larta, u përfundua në afat rekord.

U ngritën pagat për të gjitha kategoritë sociale, në arsim, shëndetësi, polici, familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, për pjesëtarë të FSK-së, pensionistë, shërbyesit civilë, dhe për të gjithë bartësit e institucioneve vitale të shoqërisë. Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve, vazhdon të jetë preokupim dhe objektiv themelor, theksoi kryeministri Thaçi.

Kuvendi i Kosovës përfaqësohet në takimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ka marrë pjesë në Konferencën e përfaqësuesve parlamentarë të Komonveltit, në Asamblenë Parlamentare të

Këshillit të Evropës dhe po bën përpjekje që të aderojë në Unionin Ndërparlamentar dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë. Në punën e tij, Kuvendi i Kosovës e kanë mbështetur: OSBE-ja, AER-i, USAID-i, NDI-ja, UNDP-ja, GTZ-ja, DCAF-i, Parlamenti Evropian, Kongresi Amerikan, parlamentet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe shumë parlamente tjera të vendeve mike, të cilëve në këtë përvjetor jubilar. Për gjithë këtë, kryekuvendari Krasniqi me këtë rast u shprehu mirënjohje të veçantë këtyre institucioneve.

Administrata e Kuvendit, e ndihmuar gjithanshëm nga donatorët, në dekadën tjetër po hyn më e përgatitur dhe e aftësuar për të përbushur obligimet e saj, duke ofruar mbështetje profesionale dhe teknike për realizimin e programit të punës dhe qëllimeve të Kuvendit. Administrata i ka ngritur kapacitetet dhe aftësitë e punës, drejt një stafi të kualifikuar. Janë bërë përpjekje drejt përmirësimit të përfshirjes së gjithë komuniteteve pakicë në administratë. Kuvendi punon sipas Planit Strategjik afatmesëm, i cili këto kohët e fundit është azhurnuar me objektiva të reja, me përgjegjësi konkrete dhe me afate të përcaktuara. Mbi bazën e tij hartohen planet vjetore të punës. Rregullorja e Punës së Kuvendit është përmirësuar vazhdimisht, kurse aktualisht është në përfundim drafti i Rregullores së re, më të avancuar.

Gjatë gjithë periudhës dhjetëvjeçare kanë vazhduar investimet kapitale për përmirësimin e kushteve të punës në Kuvend. Një prioritet i veçantë i Kuvendit ka qenë dhe vazhdon të jetë siguri i hapësirës për punë dhe logjistikë për komisionet e grupet parlamentare, për deputetë si dhe për krahja me personel adekuat, mbështetje financiare dhe teknike për ngritjen e efikasitetit të punës.

Shqiptarët të bashkuar në Jubileun e 100- vjetorit të pavarësisë së Shqipërisë

"Mund të ndërrohen rendet shoqërore, ekonomike dhe politike, mund të ndërrohen formacionet e administrimit, ritmet e zhvillimit, por Shqipëria, shteti i shqiptarëve, atdheu i shqiptarëve të shuar e të përjetshëm, të gjallë e të pa lindur do të rrojë përjetë të jetëve".

Fjala e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës Dr. Jakup Krasniqi

E nderuara kryetare e Kuvendit të Shqipërisë, zonja Topalli.

I nderuari president Topi,

I nderuari kryeministër Berisha,

Të nderuar deputet e deputete,

Shqiptarë kudo që jeni,



Pamje nga sala në Kuvendin e Shqipërisë

Viti 2012 është vit i përmbylljes së pavarësisë së mbikëqyrur, si shenjë e arritjes së standardeve demokratike. "Institucionet ndërkombëtare që janë të pranishme në Kosovë kanë mbështetur fuqishëm agjendën që çon drejt kësaj përmbylljeje. Prandaj sot, shfrytëzoj rastin për t'i falënderuar për bashkëpunim dhe kontributin e tyre në forcimin e shtetit të Kosovës. Falënderojmë shtetet anëtare të Grupit Ndërkombëtare Drejtues, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shtetet e Bashkimit Evropian, NATO-n dhe të gjitha institucionet tjera që e mbështesin vendin tonë", theksoi ai.

Duke folur për të arriturat e vendit në zhvillimin e gjithanshëm, kryeministri Thaçi vlerësoi përkushtimin e vazhdueshëm institucional, me filozofinë e qeverisjes së mirë dhe të përgjegjshme, ndaj brenda katër vjetësh u shënuan zhvillime të rëndësishme në Kosovë. U krijuan më shumë vende të reja të punës, e përmirësua infrastruktura e përgjithshme kudo

në Kosovë. Një pjesë e autostradës moderne Vërmicë-Merdar, duke përmbushur kriteret më të larta, u përfundua në afat rekord.

U ngritën pagat për të gjitha kategoritë sociale, në arsim, shëndetësi, polici, familje të dëshmorëve dhe invalidëve të luftës, për pjesëtarë të FSK-së, pensionistë, shërbyesit civilë, dhe për të gjithë bartësit e institucioneve vitale të shoqërisë. Përmirësimi i cilësisë së jetës së qytetarëve, vazhdon të jetë preokupim dhe objektiv themelor, theksoi kryeministri Thaçi.

Kuvendi i Kosovës përfaqësohet në takimet e Asamblesë Parlamentare të NATO-s, ka marrë pjesë në Konferencën e përfaqësuesve parlamentarë të Komonveltit, në Asamblenë Parlamentare të Këshillit të Evropës dhe po bën përpjekje që të aderojë në Unionin Ndërparlamentar dhe organizma të tjerë ndërkombëtarë.

Në punën e tij, Kuvendin e Kosovës e kanë mbështetur: OSBE-ja, AER-i, USAID-i, NDI-ja, UNDP-ja, GTZ-ja, DCAF-i, Parlamenti Evropian, Kongresi Amerikan, parlamentet e vendeve të Bashkimit Evropian dhe shumë parlamente tjera të vendeve mike, të cilëve në këtë përvjetor jubilar. Për gjithë këtë, kryekuvendari Krasniqi me këtë rast u shprehu mirënjohje të veçantë këtyre institucioneve.

Ky pagëzim mëvetësie e mos varësie, kjo shpallje, ky kumt, që lë me një anë plagët, gjymtimet e vurratat, u bë streha fizike, shpirtërore e mendore e gjithë shqiptarëve anekënd rruzullit për një shekull të tërë. Prandaj ata, kudo në Evropë, në Australi e Amerikë, si në një kor madhështor do të këndojnë: Mbahu nëno, mos kij frikë!



Kryetari i Kuvendit, Jakup Krasniqi në Kuvendin e Shqipërisë

Formula e Pagëzimit, si për të përligjur ritin e moçëm, erdhi e u shfaq sërish pa u mbushur shekulli: “Ne, udhëheqësit e popullit, të zgjedhur në mënyrë demokratike, nëpërmjet kësaj Deklarate shpallim Kosovën shtet të pavarur dhe sovran”. Kjo formulë do të shqiptohet pikërisht, më 17 Shkurt 2008.

Derisa të parën e shqipton i dituri Pal Engjëlli, bashkëpunëtori i ngushtë i Gjergj Kastriotit, më 1462; të dytën, i mençuri plak i Vlorës, Ismail Qemali, me bashkëpunëtor trimin, Isa Boletini; të tretën, kuvendarët e Kosovës, dalë nga supet e dalzotësit, Adem Jashari.

Në të tri rastet, si në vetë mrekullinë, shfaqet atributi i simbiozës: mençuri-trimëri. Vepra që rezulton si amalgamë e mendjes, shpirtit dhe zemrës nuk ka se si të mos marrë dorë nga aureola hyjnore.

E thashë më herët se përvjetorët e këtillë janë doemos edhe bazamente përsiatjeje e reflektimi. Në momente kyçe dilemash, Noli mendjendritur, siç është e ditur, shtronte sentencën hipotetike: Ç'do të bënte Skënderbeu në një rrethanë të këtillë?

A nuk është koha dhe vendi që, duke marrë shkas nga ky përvjetor i lavdishëm dhe nga kjo plejadë njerëzish të famshëm, burrështetasit, liderët dhe udhëheqësit e sotëm shqiptarë t'i thërrasin mendjes, rezonancës së arsyes,

harmonisë së veprimit? Sipas përvojës së të parëve, them se kjo është traseja unike e ardhmërisë. Ndjesa, pendesa dhe mirëkuptimi le të na bëhen udhërrëfyes për tejkalimin e vetvetes, të egos dhe të veseve!

Pa pretenduar të bëj historinë e ngjarjes madhore, zaten ngjarjet e mëdha të historisë së një populli e bëjnë vetiu historinë, nuk kam sesi të mos them se 28 Nëntori i 1912-ës, kapërcen atë që quhet kthesë, atë që quhet nyje. Në jetën e shqiptarëve ajo është epoka e epokave, pika që ndan mileniumet.

Që andej e këtej e tutje, mund të ndërrojnë rendet shoqërore, politike e ekonomike; mund të ndërrojnë formacionet e administrimit, ritmet e zhvillimit, çalimet dhe hovëzimet kulturore; po Shqipëria, shteti i shqiptarëve, atdheu i shqiptarëve të shuar e të përjetësuar, të gjallë e të pa lindur do të rrojë për jetë të jetëve.

Në këtë përvjetor jubilar, prandaj, s'kam arsye dhe s'dua ta fsheh për asnjë çast, për asnjë rrethanë ndjenjën e krenarisë, mbushjen emocionale, kënaqësinë njerëzore. E kundërta do të më dukej pozë e çnaturuar.

Për jetë të jetëve Shqipëria “...më vete, e lirë dhe e mosvarme”!

Faleminderit!

Hungaria mbështet Kosovën në procesin liberalizimit të vizave dhe të integritimeve euro-atlantike

- Marrëdhëniet historike ndërmjet dy vendeve përtërihen dhe forcohen nëpërmjet bashkëpunimit në fusha të ndryshme.



Takimi me László KÖVÉR

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti kryetarin e Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, z. László KÖVÉR.

Duke i uruar mirëseardhje në Kosovë homologut të tij hungarez, KÖVÉR, kryeparlamentari Krasniqi ka përkujtuar marrëdhëniet e mira historike ndërmjet dy vendeve, të cilat është shprehur i bindur se do të përtërihen dhe forcohen. Ai ka vlerësuar mbështetjen e vazhdueshme të Hungarisë për Kosovën, si dhe politikën e saj konsekuente për zgjerimin e BE-së.

Z. Krasniqi e ka njoftuar homologun e vet punën e përkushtuar të legjislativit të vendit, për marrëdhëniet me Parlamentin Evropian, me vendet e BE-së, si dhe me vendet e rajonit. Ai është shprehur optimist se marrëdhëniet e shkëlqyeshme ndërmjet dy vendeve dhe parlamenteve do të zgjerohen edhe tek institucionet e tjera dhe do të shtrihet edhe në fusha të tjera të jetës, si në ekonomi, arsim, kulturë. Z. Krasniqi i ka kërkuar homologut hungarez, që vendi i tij ta mbështesë Kosovën në procesin liberalizimit të vizave dhe të integritimeve euro-atlantike, duke ndikuar edhe tek pesë vendet e BE-së që ta njohin Kosovën, si

parakusht për marrëdhënie kontraktuale të vendit tonë me BE-në.

Duke e falënderuar kryeparlamentarin Krasniqi për ftesën dhe për mundësinë që i ka dhënë për të vizituar për herë të parë Kosovën, kryetari i Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, z. László KÖVÉR, ka përkujtuar tri takimet e tij të mëparshme me kreun e Kuvendit të Kosovës, të cilat kanë vënë themelet e miqësisë dhe kanë hapur mundësi të gjera të bashkëpunimit, në interes reciprok, ndërmjet dy vendeve.

Ai e ka bërë të qartë politikën e Hungarisë, gjatë kryesimit të BE-së, për domosdoshmërinë e zgjerimit të BE-së, duke e anëtarësuar Kosovën edhe vendet e tjera të Ballkanit Perëndimor dhe duke u ndjerë krenar, që ka arritur ta realizojë anëtarësimin e Kroacisë në këtë Union. Kryeparlamentari hungarez është shprehur optimist se edhe Projekti i Binjakëzimit të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë me Kuvendin e Kosovës (i financuar nga BE dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë) që do të promovohet sot, do ta mbështesë profesionalisht legjislativin e Kosovës , në rrugën e ngritjes së kapaciteteve dhe të integritimeve.

Kosova ka mundësi historike për të ecur përpara

- Projekt i një rëndësie të veçantë për Kuvendin e Kosovës
- Hungaria me praktikat më të mira do të shërbejë si shembull i përafrimit të Kosovës drejt BE-së
- Institucionet e Kosovës janë gjithnjë të angazhuara në një proces të përhershëm reformash, për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe sfidave të kohës me të cilat përballen



Takimi me László KÖVÉR

Në kuadër të vizitës së kryetarit të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, z. László KÖVÉR, në Kuvendin e Kosovës u organizua ceremonia zyrtare e hapjes së Projektit të Binjakëzimit financiar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë, i cili do të zbatohet posaçërisht nga Kuvendi Kombëtar i Hungarisë.

Pas përshëndetjes së homologut hungarez, z. László KÖVÉR, z. Kholdaun Sino nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian, si dhe pjesëmarrësit e tjerë, kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi tha se Kuvendi i

Kosovës, që nga konstituivi, e deri më tani është duke bërë hapa të rëndësishëm drejt konsolidimit të tij si institucion funksional dhe efikas legjislativ. Vazhdimisht po shënohet përparim në ushtrimin e funksioneve që ka në ligjvënien, mbikëqyrje, përfaqësim të interesave të qytetarëve dhe në ngritjen, zhvillimin dhe fuqizimin e kapaciteteve profesionale administrative. Institucionet shtetërore janë gjithnjë të angazhuara në një proces të përhershëm reformash për t'iu përgjigjur kërkesave të qytetarëve dhe sfidave të kohës me të cilat përballen.

Mbështetje në procesin e përafrimit të legjislacionit me normat dhe standardet e BE-së

Në vijim kryekuvendari Krasniqi tha se Kosova, përkatësisht Kuvendi i saj, që nga konstituimi e deri më tani është përkrahur dhe mbështetur vazhdimisht nga shumë parlamente të shteteve të ndryshme, organizata qeveritare dhe

joqeveritare. Kuvendi vazhdon rrugëtimin e konsolidimit të tij institucional me përkrahje të mëtejme nga organizata, institucione dhe parlamente të konsoliduara dhe me traditë demokratike siç është edhe ky moment i

inaugurimit zyrtar të fillimit të projektit të Binjakëzimit.

Ky projekt është i një rëndësie të veçantë për Kuvendin e Kosovës, ndërsa financohet nga Bashkimi Evropian, menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian në Kosovë dhe po implementohet nga Kuvendi Kombëtar i Hungarisë.

Projekti i Binjakëzimit ndërlidhet drejtpërdrejtë në rritjen e efikasitetit të punës së Kuvendit në ushtrimin e funksioneve të tij, me theks të posaçëm në avancimin funksionit mbikëqyrës, transparencës së punës, forcimit të kapaciteteve administrative, rritjes së profesionalizmit, të cilësisë së punës dhe të shërbimeve nga ana e administratës.

Projekti do të mbështesë Kuvendin e Kosovës edhe në procesin e përafrimit të legjislacionit me normat dhe standardet e BE-së përmes:

- përmirësimit të kapaciteteve legjislative dhe të mbikëqyrjes,
- forcimit të menaxhimit të resurseve njerëzore,
- përmirësimit të kapaciteteve për përafrim me

legjislacionin e BE-së,

- forcimin e rolit të Komisionit për Integritet Evropian dhe

- ngritjen e njohurive të stafit dhe të deputetëve për çështjet e integritetit evropian dhe aki komunitare (acquis communautaire).

Projekti në fjalë do të ndihmojë në rrugën, të cilën duhet ta ndjekë Kuvendi drejt përmbushjes së standardeve të një Kuvendi demokratik dhe do të shërbejë si praktikë e rrugëtimit në përmbushjen e detyrave që dalin nga procesi historik i integritetit evropian të Republikës së Kosovës, por edhe të planeve dhe objektivave që ka para vetes, theksoi kryekuvendari Krasniqi.

“Me këtë rast dua ta falënderoj Bashkësinë Evropianë dhe Zyrën ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë për mundësimin e realizimit të këtij projekti, si dhe Kuvendin Kombëtar të Hungarisë për bashkëpunim të mirë dhe miqësor që kemi”, u shpreh z. Krasniqi.

Bashkimi Evropian do të ofrojë modele të shteteve të Rajonit nga pasojat e luftës

Duke iu drejtuar të pranishmëve, z. László KÖVÉR, kryetar i Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, në fillim i bëri një vështrim historik të kaluarës së Ballkanit, në këtë mes edhe të Kosovës, duke u ndalur edhe në kontributin e forcave të NATO-së që dhanë në mbrojtjen e Kosovës, për të krijuar kushte e hapësirë drejt integritetit evropian të saj. Intervenimi i forcave të NATO-s në Kosovë krijoi kushte për stabilitet në Ballkan, në funksion të zgjerimit të BE-së edhe me shtete nga ky Rajon. Bashkimi Evropian, tha në vijim z. László KÖVÉR, do të ofrojë modele të këndelljes së shteteve nga pasojat e luftës. “Ne do të ndihmojmë në stabilitetin e Kosovës sipas kritereve evropiane. Kosova ka mundësi historike për të ecur përpara. Do të angazhohemi për tranzicionin e Kosovës të bëhet në mbështetje me përvojat më të mira të shteteve të BE-së. Hungaria me praktikën më të mira do të shërbejë si shembull i mirë i përafrimit të Kosovës drejt BE-së. Do të

angazhohemi që disa gabime që kanë bërë disa shtete në rrugën drejt BE-së, të mos i bëjë Kosova. Hungaria do ta përkrahë integritetin evropian të Kosovës, jo me deklarata, por praktikisht, siç do të veprohet edhe më këtë Projekt binjakëzimi, në kuadër të të cilit brenda dy vjetësh do të realizohen 75 programe në Kosovë.

Z. Khaldaon Sinno, ushtrues i detyrës së shefit të Zyrës Ndërlidhëse të Komisionit Evropian në Kosovë, theksoi se Kosova ka një të ardhme evropiane, në funksion të të cilit do të jetë edhe ky projekt, në kuadër të të cilit angazhime kryesore do të jenë legjislacioni, proceset financiare dhe integriteti. Ai shfaqti shpresën se ky partneritet në mes BE-së, Hungarisë, Komisionit Evropian dhe Kosovës do të jetë i suksesshëm, madje ai do të vazhdojë edhe pas periudhës dyvjeçare.

Takim i Kryekuvendari hungarez z. László KÖVÉR me përfaqësues të dy komisioneve parlamentare



Takimi i László KÖVÉR me komisionet parlamentare

Kryetari i Komisionit për Punë të Jashtme, Albin Kurti, falënderoi shtetin hungarez për njohjen e shtetit të Kosovës, pas shpalljes së pavarësisë së vendit. Gjatë këtij takimi Kurti tha se shteti i ri i Kosovës vazhdon të përballlet me sfida të shumta meqë akoma nuk kemi zhvillim të mjaftueshëm ekonomik dhe kemi varfëri e papunësi të madhe në vend. Ai tha se përveç mungesës së zhvillimit ekonomik, kemi edhe problemin e madh politik. “Çereku i territorit tonë është i mbuluar nga strukturat ilegale e armiqësorë të Serbisë që kanë për qëllim ta bëjnë shtetin e Kosovës jo funksional që të dështojë, duke deklaruar se duan model të Bosnjës për Kosovën.”, theksoi Kurti.

Tutje ai shtoi se ekziston konsensus brenda forcave politike në Kuvendin e Kosovës për integritet evropian dhe jemi të interesuar që Kosova sa më parë të bëhet shtet normal, me të drejtë për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian dhe kjo të ndodh sa më parë.

Kryetari i Kuvendit Kombëtar të Hungarisë, László KÖVÉR, theksoi se Hungaria do të vazhdojë angazhimin e saj që Kosovës, Shqipërisë, Maqedonisë, Serbisë dhe secilit shtet, që nuk është anëtar i BE-së, t'i ofrohet mundësia e anëtarësimit në BE.

Hungaria është e përkushtuar në vazhdimin e integriteteve evropiane dhe zgjerimin e BE-së dhe se askush nuk ka arsye që të dyshojë në sinqeritetin dhe përkushtimin e tyre në këtë drejtim. “Ju falënderojmë që na keni nderuar

me besimin që keni zgjedhur pikërisht Hungarinë që të jetë partneri implementues i binjakëzimit. Kuvendi i Hungarisë do të jap ndihmën e vet rreth procesit përgatitor në rrugën drejt BE-së dhe besojmë, se gjatë këtyre dy vjetëve ju do ta shfrytëzoni këtë mundësi”, theksoi kryekuvendari hungarez duke folur për Projektin e Binjakëzimit të Kuvendit Kombëtar të Hungarisë me Kuvendin e Kosovës.

Me këtë rast foli edhe nënkryetari i Kuvendit dhe i Komisionit për Integritet Evropian, Xhavit Haliti, duke theksuar se Kosova tashmë ka hyrë në një proces negociues ku pretendohet të jemi pjesë e Evropës, mirëpo duke qenë në dijeni për vështirësitë që do t'i ketë vendi, përpjekjet do të vazhdojnë për të dhënë provimin që Kosova të bëhet pjesë e Evropës.

Edhe nënkryetari i Kuvendit të Kosovës, Sabri Hamiti, mes tjerash tha se të gjithë janë në dijeni se vendi duhet të ketë një sponsor të fuqishëm politik për të hyrë në Evropë dhe ne kërkojmë një mbështetje të tillë. “Kërkojmë ndihmë në mënyrë që ta ndërtojmë Kosovën si një vend normal, andaj, na nevojitet ndihmë ekonomike dhe zhvillim i brendshëm”.

Në vijim ai foli për çështjen e liberalizimit të vizave, duke theksuar se Kosova ka prani enorme të BE-së si mbikëqyrës, e në anën tjetër paradoksale ajo është vendi më i mbyllur. “Ky vend ka nevojë për hapje, për ndihmë, por jo për kontroll”, tha me këtë rast Hamiti.

Kosovë – Maqedoni impulse të reja bashkëpunimi

- Vlerësohen marrëdhëniet ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe shtrohet nevoja e thellimit të mëtejshëm ndërmjet tyre
- Kjo vizitë do t'i japë impulse të reja bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve dhe parlamenteve tona

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, i shoqëruar nga nënkryetarët Xhavit Haliti, Sabri Hamiti e Enis Kervan, ambasadori i Kosovës në Shkup, Skënder Durmishi e bashkëpunëtorë të tjerë, priti në takim kryetarin e Kuvendit të Republikës së Maqedonisë, z. Trajko Veljanoski dhe delegacionin parlamentar që e shoqëronte, me të cilin bisedoi për bashkëpunimin ndërmjet dy shteteve e veçanërisht ndërmjet dy parlamenteve, si dhe mundësisë së thellimit të mëtejshëm të këtij bashkëpunimi.

Duke i uruar mirëseardhje kryetarit të Parlamentit të Maqedonisë, kryetari Krasniqi dha një pasqyrë të punës brenda Kuvendit të Kosovës dhe foli për bashkëpunimin që ai ka me parlamentet e vendeve të rajonit dhe më gjerë. Në këtë kontekst, kryeparlamentari Krasniqi çmoi bashkëpunimin

me Parlamentin e Maqedonisë dhe shtoi se kjo vizitë do t'i japë përmbajtje dhe impulse të reja bashkëpunimit të mëtejshëm. Kryetari Krasniqi shtoi nevojën e bashkëpunimit edhe ndërmjet administratave të të dy parlamenteve.

“Ne, si kuvende, e kemi obligim ta shtojmë bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve tona, t'i nxisim të dy ekzekutivet tona që t'i shtojnë marrëdhëniet në të gjitha fushat: ekonomike, arsimore, shëndetësore etj., për ta ndryshuar dhe lehtësuar kualitetin e jetës së qytetarëve të vendeve tona”, theksoi kryeparlamentari Krasniqi. Në vazhdim, kryetari i Kuvendit të Kosovës u ndal edhe në fqinjësinë e mirë që Kosova kultivon me të gjithë fqinjët e saj, me përjashtim të Serbisë, e cila vazhdon ta mos e pranojë realitetin në Kosovë.



Takimi me Trajko Veljanoski

Duke folur për perspektivën evropiane të rajonit, kryeparlamentari Krasniqi theksoi se kjo shtron nevojën e një bashkëpunimi edhe më të madh ndërmjet vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe të përqafimit të vlerave evropiane. Ai foli, gjithashtu, edhe për pengesat që Kosova po has në rrugën e saj të integritetit, si pasojë e mosnjohjes nga të gjitha vendet e Bashkimit Evropian.

Duke e falënderuar kryetarin Krasniqi për pritjen dhe duke shprehur kënaqësinë që gjendet në Kosovë, kryeparlamentari maqedonas, Trajko Veljanoski, i cili në këtë vizitë shoqërohej nga anëtarë të Grupit Parlamentar për bashkëpunim me Kosovën në Parlamentin e Maqedonisë, i vlerësoi lart marrëdhëniet dhe bashkëpunimin ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë dhe shfaqti gatishmërinë që të vë në dispozicion të Kuvendit të Kosovës dhe institucioneve të tjera, përvojën parlamentare të Maqedonisë.

Ai shkoqiti dy vendime të rëndësishme të Parlamentit të Maqedonisë në vitet e fundit, në raport me Kosovën, si: miratimin e Deklaratës në të cilën rekomandohej njohja e pavarësisë së Kosovës nga Qeveria e Maqedonisë dhe ratifikimin e Marrëveshjes për demarkacionin e kufirit.

“Vizita ime sot i jep një shtytje pozitive bashkëpunimit ndërmjet dy shteteve. Mund të shprehim kënaqësinë që nuk kemi asnjë çështje të hapur ndërmjet dy shteteve. Në Kuvendin e Maqedonisë ratifikohen shumë marrëveshje dhe kontrata ndërmjet Maqedonisë dhe Kosovës. Dhe, kjo është një shenjë për një bashkëpunim intensiv ndërmjet dy vendeve tona”, u shpreh kryeparlamentari maqedonas, duke shprehur kënaqësinë që ndërmjet Kosovës dhe Maqedonisë ka një këmbim shumë të mirë tregtar, por, shtoi nevojën e rritjes së mëtejme të tij.

Kuvendi i Republikës së

Në mbështetje të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenet 6.1, dhe 38 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në mbledhjen plenare të mbajtur më 31 janar 2012 , miratoi këtë:

REZOLUTË

Për përfundimin e Mbikëqyrjes Ndërkombëtare të Pavarësisë

- 1- Duke njohur përparimin që ka bërë Kosova në vitet që nga Shpallja e Pavarësisë dhe përparimin që do vazhdojë ta bëjë;
- 2- Duke mirëpritur vendimin e Grupit Ndërkombëtar drejtues për të synuar përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë gjatë vitit 2012;
- 3- Duke besuar se Kosova është e gatshme të pranojë vendin e vet meritë në mesin e vendeve të pavarura të botës;
- 4- Të përkushtuar ndaj përmbushjes të të gjitha obligimeve që kontribuojnë në përfundimin e fazës së mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë duke pasur parasysh parimet kyçe të Propozimit gjithëpërfshirës për zgjedhjen e Statusit me Kushtetutën dhe me legjislacionin e Republikës së Kosovës;
- 5- Të vetëdijshëm se Kosova gjithmonë ka arritur përparimin më të madh drejt synimeve kombëtare kur forcat politike dhe udhëheqësit janë bashkuar;
- 6- Zotohet solemnisht për përkrahjen dhe përkushtimin e vet të plotë për arritjen e shpejtë, të tërësishme dhe të suksesshme të këtij synimi kombëtar, posaçërisht kalimit me kohë të të gjitha amendamenteve kushtetuese dhe legjislacionit tjetër të nevojshëm për ti dhënë fund mbikëqyrjes së pavarësisë;
- 7- Fton Qeverinë e Republikës së Kosovës, në konsultim të ngushtë me udhëheqësit e partive parlamentare të përfaqësuara në Kuvend, anëtarët e Grupit drejtues Ndërkombëtar dhe përfaqësuesin Ndërkombëtar Civil, që me prioritet të përgatisë legjislacionin i cili është i nevojshëm për të kompletuar zbatimin e Propozimit Gjithëpërfshirës, si dhe të përgatisë të gjitha amendamentet e nevojshme kushtetuese dhe legjislacionin shtesë dhe t'ia paraqesë këto Kuvendit jo më vonë se katër javë nga data e kësaj rezolute.
- 8- Në mbështetje të nenit 71 të Rregullores Kuvendit , autorizon Komisionin e tashëm ad-hoc për Reformën Kushtetuese si dhe të përgatisë amendamentet kushtetuese dhe amendamentet legjislative për miratim përfundimtar nga Kuvendi i Kosovës.

Nr. 04-R-05

Prishtinë, më 31 Janar 2012

Kosovës, Legjislatura IV

Në bazë të nenit 65.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të nenit 6 paragrafi 1 dhe 49 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës;

Duke u mbështetur në neni 1.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, i cili thotë: “Kosova është shtet i pavarur, sovran, demokratik, unik dhe i pandashëm”;

Duke shprehur mbështetjen për mbrojtjen dhe realizimin e të drejtave të komuniteteve, si dhe implementimin në tërësi të Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e statusit final të Kosovës;

Duke rikonfirmuar vullnetin për integrim institucional dhe shoqëror të komuniteteve që jetojnë në Republikën e Kosovës;

Duke u bazuar në veprimin institucional, brenda rregullave që ofron rendi juridik dhe kushtetues i Republikës së Kosovës, me propozimin e Grupeve parlamentare, miraton këtë:

DEKLARATË

- 1- Kuvendi i Republikës së Kosovës e kundërshton dhe e shpall të paligjshëm e të pavlefshëm Referendumin e strukturave paralele në komunat veriore të Kosovës, të financuara e të drejtuara nga Republika e Serbisë kundër Pavarësisë, Sovranitetit dhe Integritetit territorial të Republikës së Kosovës.
- 2- Kuvendi i Republikës së Kosovës e vlerëson këtë referendum cenim të rendit juridik dhe kushtetues të Republikës së Kosovës;
- 3- Kuvendi i Republikës së Kosovës konstaton që i ashtuquajtimi Referendum i organizuar nga strukturat ilegale, nuk prodhon asnjë efekt juridik, politik dhe si i tillë është i pavlefshëm;
- 4- Organizimet e tilla jashtë institucionale dhe ilegale dëmtojnë përpjekjet e vazhdueshme të Institucioneve të Republikës së Kosovës për integrim të komunitetit serb në jetën institucionale;
- 5- Kuvendi i Republikës së Kosovës inkurajon komunitetin serb të pjesës veriore që sa më shpejtë të angazhohet në implementimin e Propozimit Gjithëpërfshirës për zgjidhjen e Statusit të Kosovës.
- 6- Institucionet e Republikës së Kosovës konfirmojnë gatishmërinë e tyre për mbrojtjen dhe respektimin e të gjitha konventave ndërkombëtare, që garantojnë liritë dhe të drejtat e qytetarëve, si dhe të drejtat e pakicave.

Prishtinë, më 15 shkurt 2012

Kuvendi i Republikës së Kosovës, Legjislatura IV

Në mbështetje në nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
Duke ritheksuar se Republika e Kosovës është shtet i pavarur, sovran, demokratik dhe shoqëri multietnike me parime evropiane,
Duke theksuar zotimin tonë në mbrojtje të sovranitetit dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës,
Duke riafirmuar përkushtimin e Republikës së Kosovës për të ardhmen e saj euro-atlantike dhe marrëdhënieve të mira fqinjësore,
Duke ritheksuar zotimin e Republikës së Kosovës për mbrojtjen e të drejtave të të gjithë qytetarëve të saj, duke përfshirë të drejtat e komuniteteve dhe të drejtën e dyshetësisë, duke marrë në konsideratë që të gjithë ata që kanë dy shtetësi në vendet evropiane kanë të drejtë të votojnë në zgjedhjet parlamentare të cilat mbahen në shtetet në të cilat ata kanë shtetësinë përkatëse,

Në mbledhjen plenare të mbajtur me 15 mars 2012, miratoi këtë:

REZOLUTË

- 1- Theksojmë se është shkelje e sovranitetit dhe cenim i marrëdhënieve të mira fqinjësore, që të organizojë në mënyrë të njëanshme zgjedhje të përgjithshme dhe lokale në një shtet tjetër evropian;
- 2- Konkludojmë se Kuvendi i Republikës së Kosovës nuk lejon mbajtje të zgjedhjeve të Serbisë në Kosovë dhe obligon Qeverinë e Republikës së Kosovës të realizojë këtë vendim.
- 3- Kuvendi i Republikës së Kosovës dhe Qeveria e Republikës së Kosovës, njëzëshëm theksojnë se qytetarët e Republikës së Kosovës janë ta bashkuar kundër mbajtjes së çfarëdo procesi zgjedhor i cili do të minonte sovranitetin shtetëror të Kosovës, do të cenonte shtetësinë e saj, do të cenonte integritetin territorial të saj dhe rrjedhimisht do të minonte procesin e pajtimit ndëretnik në Kosovë;
- 4- Kuvendi i Republikës së Kosovës konfirmon se të gjitha subjektet politike, qofshin ato në pozitë apo opozitë, do të punojnë në përputhje me parimet evropiane, me të drejtën ndërkombëtare dhe me Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Nr. 04-R-06
Prishtinë, 15 mars 2012

Kryetari i Kuvendit,

Jakup Krasniqi

Përmirësime në rregulloren e Kuvendit

Në bazë të nenit 56 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni Funkcional ka shqyrtuar Projekt-rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe e ka paraqitur raportin me rekomandime për shqyrtim në seancë parlamentare, për lexim të parë.

Prezantimin dhe arsyetimin e Projekt-rregullores së re para Kuvendit e ka paraqitur kryetari i Nën-komisionit për Mandate e Imunitete dhe Rregullore të Kuvendit, deputeti Armend Zema



ARMEND ZEMAJ - LDK

E drejta e Kuvendit të Republikës së Kosovës, për të rregulluar organizimin e brendshëm dhe

mënyrën e punës, me Rregullore të Kuvendit, mbështetet në nenin 76 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Baza juridike për nxjerrjen e Rregullores së Kuvendit të legjislaturës së katërt si ndryshim i Rregullores së Kuvendit të legjislaturës së tretë, është Rregullorja në fuqi, neni 81.

Ndryshimi i Rregullores në fuqi, në radhë të parë është domosdoshmëria e harmonizimit me Kushtetutën e pastaj edhe synimet e progresit dhe praktikën e mira parlamentare në Kuvendin e Republikës së Kosovës.

Organizimi i brendshëm i Kuvendit dhe detyrat e përgjegjësitë e organeve janë përcaktuar me Kushtetutë. Me Kushtetutë është përcaktuar edhe rasti kur kryetari dhe nënkryetarët veprojnë si Kryesia e Kuvendit. (Neni 67 i Kushtetutës e ka përcaktuar Kryesinë). Po citoj: “Kryetari dhe nënkryetarët formojnë Kryesinë e Kuvendit. Kryesia është përgjegjëse për funksionimin administrativ të Kuvendit në mënyrën e përcaktuar me Rregulloren e Punës së Kuvendit” mbyllet citati. Duke u nisur nga ky determinim kushtetues, disa detyra të Kryesisë kalojnë në instanca të tjera, e disa i mbesin edhe më tej asaj.

- Dokumentet zyrtare për Kuvendin, të cilat deri tash i adresoheshin Kryesisë së Kuvendit për procedim të mëtejshëm, pas miratimit të këtyre ndryshimeve, duhet t'i adresohen kryetarit të Kuvendit. Po ashtu bashkëpunimi ndër-parlamentar do t'i takojë kryetarit të Kuvendit në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare dhe me

Kuvendin.

- Funksionimi administrativ i Kuvendit dhe përgatitja e miratimit të buxhetit dhe llogarive buxhetore për njësitë buxhetore të Kuvendit bashkë me çështjet tjera përcjellëse në lëmin e administratës dhe buxhetit është kompetencë e Kryesisë së Kuvendit.

- Përcaktimi i kalendarit të punimeve të Kuvendit dhe përcaktimi i propozimit të rendit të ditës për seancat plenare, të cilat deri më tash ishin në kompetencë të Kryesisë së Kuvendit, me propozim-ndryshimet e reja do të jenë në kompetencë të konferencës së kryetarëve.

- Konferenca e kryetarëve është një trup i ri, i cili ka disa cilësi të organit ndër - fraksional, në këtë rast pozitë – opozitë. Konferencën e kryetarëve nuk e zgjedh Kuvendi por përbëhet prej kryetarit të Kuvendit dhe nënkryetarëve të të gjitha grupeve parlamentare.

Konferenca është një trup koordinues operativ i cili koordinon dhe i bën operative në aspektin procedural, aktivitetet parlamentare. Ajo punon mbi principin e konsensusit dhe në rast të mos arritjes së konsensusit, çështjet i adresohen Kuvendit për vendimmarrje.

- Organizimi i brendshëm i Kuvendit përcakton mënyrën e funksionimit të Kuvendit, në seancën plenare dhe mënyrën e nxjerrjes së akteve nga Kuvendi.

Propozim-rregullorja e Kuvendit, si tërësi, është një dokument rregullues solid dhe bazë e mirë për ta begatuar edhe më tej me standardet dhe praktikën më të mira të demokracive të zhvilluara, si ajo amerikane e euro-perëndimore.

Falënderoj anëtarët e nën-komisionit dhe Institutin Kombëtar Demokratik Amerikan – NDI për mbështetjen profesionale; OSBE-në për organizimin e disa punësorive dhe mbështetjen e ekspertëve, si dhe Komisionin



Albulena HAXHIU - VV

Neni 18, të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit. Është hequr paragrafi ku deputeti ka të drejtë të ketë qasje në të dhënat materiale dhe në dokumentet zyrtare të cilat përgatiten ose mblidhen nga trupat e punës së Kuvendit,

nga stafi i Kuvendit, Qeveria, ministritë, doganat dhe administratës. Kjo pikë duhet të shtohet, pasi për ne si Grup parlamantar është mjaft e rëndësishme.

Neni 14,- deklaratimet e lira të deputetëve dhe të grupeve parlamentare. Është mirë që janë shtuar 10 minuta në deklaratimet e lira të deputetëve. Mirëpo koha e caktuar për një deputet është vetëm 3 minuta. Kaq kohë ka edhe një deputet, tek e drejta e replikës, kurse tek deklaratimet e lira ngrihet një çështje shumë e rëndësishme dhe kjo kohë, vetëm 3 minuta, jo gjithmonë mjafton.

Neni 46 paragrafi 5 mocionet procedurale

thuhet se;- “ kur deputeti parashtrohet mocion procedural se i janë shkelur të drejta e tij, kryetari i Kuvendit e shqyrton mocionin dhe më së voni në seancën e ardhshme e informon Kuvendin, nëse mocioni është i vlefshëm. Kur janë shkelur të drejtat e tij kryetari e urdhëron shkelësin të korrigjohet. Por çka ndodhë nëse të drejtat e deputetit janë shkelur nga kryetari i Kuvendit? Neni 50, tek kuorumi, vendimmarrja dhe votimi. Qeveria ka ushtruar presion në Kuvend, tek deputetët, si për çështjen e zgjedhjes së presidentit, votimit për ligje ose jo, mocioneve të ndryshme. Ne mendojmë se duhet të jetë pikë e veçantë, e cila ndalon rreptësisht çdo tentim apo ndikim përmes formave të ndryshme të presionit në votimin e deputetit. Po kështu të ndalohen pauzat apo pushimet gjatë votimit. Asnjë deputet, anëtar Qeverie apo kryetari i Kuvendit, nuk duhet të ketë të drejtën ta ndërpresë seancën para votimit.



Ardian GJINI, Kryetar i grupit parlamentar - AAK

Mendoj se Kuvendi i Kosovës për katër legjislaturat ka filluar që ta ndërtojë fizionominë e vet politike, fizionominë e vet të funksionimit dhe ajo që të gjithë ne bashkërisht për një kohë të gjatë e kemi mësuar,

është se demokracia merr kohë dhe zhvillohet hap pas hapi.

Kjo ka ndodhur edhe në këtë Rregullore të punës së Kuvendit të Kosovës, besoj për shkak se është

avancuar ajo pjesë, e cila mund të avancohet, për shkak se në Kuvend - në Parlament, gjithmonë ndodhin negociata, gjithmonë ndodhin marrëveshje midis forcave politike, ndodhin pjesërisht për shkak të asaj, se grupet politike kanë mendime dhe interesa të ndryshme, dhe këto mendime dhe interesa duhet të harmonizohen në mënyrë që të kemi rregullore, e cila bënë atë që të gjithë të pajtohen të paktën për ato që janë arritur.



Hamza BALJE - 6+

Ako pogledamo član 23. tačka 1. kaže se da poslanik mora da bude član najmanje u jednoj parlamentarnoj komisiji, što ranije nije bilo slučaj.

I tačka 5. istog ovog člana, u nastavku se kaže da se to određuje od strane predsednika Skupštine

Republike Kosova. A misli se na one zastupnike,

koji nemaju mogućnosti da formiraju svoje parlamentarne grupe. A znate da u Parlamentu imamo više takvih zastupnika i da se njihova jačina zasniva i bazira na učešće u radu Skupštine Republike Kosova, a ako nisu članovi nijedne komisije, njihova jačina se gubi, kao što to stoji u tački 3. sastav parlamentarne komisije reflektira političku snagu parlamentarnih grupa i ja bih tu dodao i zastupnika.



Arsim BAJRAMI - PDK

Pas 10 viteve parlamentarizëm, në Republikën e Kosovës janë krijuar disa përvoja autoktone parlamentare dhe është madhështia e një vendi, ku krahas përvojave ndërkombëtare, praktikave më të mira parlamentare, krijon edhe praktika vendore dhe këto

praktika i instalon në jetën e vet parlamentare.

Unë doja të ndalesha në disa momente që i konsideroj të rëndësishme.

Momenti i parë është stimulimi i aktivitetit aktiv të Parlamentit në ligj – dhënie, sepse Parlamenti me Kushtetutë është organ legjislativ, pra nuk është organ më i lartë i shtetit, por është Pushteti Legjislativ. Në të vërtetë, Rregullorja e Kuvendit ka pak dispozita, të cilat stimulojnë një qasje aktive të Parlamentit për ti promovuar iniciativa Parlamentit në ligj-bërje. Është fakt edhe në praktikën parlamentare të vendeve të tjera, që mbi 90% të iniciativave priten nga Qeveria apo nga sponsorët e tjerë.

Mendoj se në Rregullore duhet të instalohen mekanizmat me të cilët stimulohen dhe mbështeten iniciativat e Parlamentit në ligj dhënie.

Momenti i dytë është forcimi i kapaciteteve administrative të Parlamentit, pra forcimi i të ashtuquajturës logjistike parlamentare. Edhe në Raportin e fundit të progresit, ne i kemi parë 3-4 pozicione të ndryshme, që kanë të bëjnë me Parlamentin dhe që kërkojnë rritjen e kapaciteteve të konsulencës legjislative.

Unë propozoj që në kuadrin e diskutimit për Rregulloren e organizmit të brendshëm të administratës së Kuvendit të formohen tri njësi të reja

që do të rrisin kualitetin dhe do të mundësojnë një punë më të planifikuar në sferën legjislative.

- Njësia për evitimin e kolizionit të ligjeve, - Njësia për njësimin e ligjeve, - Njësia profesionale e redaktuarës ligjore.

Momenti i tretë është:- Stimulimi i iniciativave qytetare. Kohë më parë ne kemi miratuar Ligjin për iniciativat qytetare, të cilin e kemi amendamentuar dhe kemi afirmuar të drejtën e 10.000 shtetasve që të propozojnë dhe të paraqiten si propozues të ligjeve.

Në këtë rregullore, Komisioni këtë nen e ka shkruar para se të hyjë ky ligj në fuqi, sepse këtë ligj e kemi miratuar kohë më parë. Ne kemi paraparë disa procedura solemne të cilat zhvillohen në Kuvendin e Kosovës për rastet, kur kemi dorëzim të peticioneve, apo ligjeve të mbështetura nga 10.000 qytetarë.

Ndaj në rregullore duhet të krijohet një dispozitë, e cila rregullon këto procedura, pra procedurat e pranimit të një peticioni apo ligji nga 10.000 shtetas, të cilat duhet të zhvillohen në mënyrë solemne në zyrën e kryetarit të Kuvendit apo në një ambient të Parlamentit.

Momenti katërt është:- Votimet që bëhen në Parlament me 2/3. Në Kushtetutën tonë kemi një 20 situata të ndryshme, ku votimi i ligjeve bëhet me 2/3 apo me shumicën e dyfishhtë.

Kolegët që kanë hartuar rregulloren, i kanë rregulluar mirë procedurat e miratimit të ligjeve në të gjitha leximet dhe votimet, por mendoj se kemi nevojë edhe për dy-tri nene ku saktësisht definohen rastet e votimit me 2/3 dhe procedurat e votimit me 2/3, sepse në praktikën tonë kemi pasur paqartësi apo kemi pasur shkelje të Kushtetutës, duke mos e kuptuar votimin me 2/3, dhe është e nevojshme, që Rregullorja, në këtë drejtim, t'i përmbajë të gjitha segmentet - edhe të kuorumit, edhe të procedurës së votimit



Albin KURTI - VV

Te shtojca numër 2, ka një dallim në titull ndërmjet versionit në shqip dhe në serbisht. Në shqip thuhet vetëm “fushëveprimi i komisioneve parlamentare”, ndërkaq në serbisht është edhe fjala “përgjegjësi”, siç është në versionin aktual të Rregullores së punës së Kuvendit.

Pra fjala “përgjegjësi” është hequr në shqip dhe tash nuk e di se cili është gabim, mirëpo duke e lexuar këtë Projekt-rregullore nuk do mend se në fakt versioni në shqip duket të jetë i saktë, me qenë se përpjekja ka qenë që të hiqet sa më shumë roli i komisioneve parlamentare, prandaj edhe është hequr fjala “përgjegjësi”, e cila është aq afër shprehjes tjetër “kompetencë”. Ndërkaq fushëveprimi është më tepër një zonë ku ndodhet komisioni dhe në të cilin mund të veprojë, kurse fjala “përgjegjësi” ka të bëjë me kompetencën, ka të bëjë me rolin dhe rëndësinë që e luan komisioni.

Pra, më shumë duket që nuk e kanë hequr fjalën “përgjegjësi” në versionin serbisht se sa që e kanë hequr gabimisht në versionin shqip.

Më tutje, tek kompetencat përkatësisht fushëveprimin

e Komisionit për punë të jashtme, mund të konstatojmë që një numër i madh i përgjegjësive në fakt është eliminuar.

Pra, është eliminuar ajo që thuhet në Rregulloren aktuale që “në koordinim me kryetarin dhe me Kryesinë e Kuvendit kemi ndërtimin e bashkëpunimit të parlamenteve të shteteve tjera”. Mandej është hequr shoqërimi i kryetarit të Kuvendit në takimet parlamentare ndërkombëtare. Po ashtu edhe i ministrit të Punëve të Jashtme, në takime të caktuara të rëndësishme. Është hequr, që është shumë e rëndësishme, ratifikimi në bllok ose ndaras i traktateve ekzistuese, të cilat Kosova dëshiron t'i nënshkruajë. Është hequr edhe përcjellja e negociatave të udhëhequra nga Qeveria, për bashkëpunim të saj në traktate të reja dhe thuhet për Komisionin e Punëve të Jashtme, që e nis debatin për ratifikimin e tyre.

Gjithashtu, është hequr edhe ajo se ky komision mund të kërkojë të dhëna konkrete, duke i përfshirë edhe raportet e drejtpërdrejta të ministrave, ose të personave të tjerë përgjegjës, kur kjo kërkohet nga Komisioni. Pra, kemi një rrudhje të kompetencave, që është reflektuar, me gjasë, në heqjen e fjalës “përgjegjësi” dhe vetëm në lënien e fjalës “fushëveprim”.



Sabri HAMITI, nënkryetar i Kuvendit - LDK

Unë s'do ta zgjas bisedën, sepse do t'i them vetëm dy-tri çështje, meqë unë dëgjova se secili e lavdëroi punën e komisionit, tani thonë shumë vërejtje, që i bie që s'del se qenka kaq e përsosur, logjikisht.

Në memorandumit shpjegues thuhet, se kjo rregullore është bazuar tek nën krahassimi me rregulloret evropiane, por nuk tregohet me cilat. Më pas thuhet se është e re.

E re është vetëm për një gjë, që funksionet që i ka pasur kryesia, si organ rreth rendit të ditës, i kalohet një institucioni të ri, që quhet konferenca e kryetarëve.

Këtu shpjegohet se njëra, pra konferenca e kryetarëve merr kompetenca procedurale ligjore, ndërsa tjetra, Kryesia kompetenca procedurale administrative.

Unë nuk po e shpjegoj më tej këtë, vetëm kërkoj të shikohen mirë e mirë nenet 64 dhe 67 të Kushtetutës. Atje shihet se si votohet dhe si formohet Kuvendi, edhe si votohet dhe formohet udhëheqësia e tij politike. Sepse, më duket kolegu Bajrami tha; - "kemi përvoja autoktone parlamentare". Kjo është e vërtetë, sepse kemi edhe përvoja autoktone, "sui generis", të përfaqësimit.

Nuk ka Kuvend në botë që pakica është shumicë vazhdimisht. Në Kuvendin tonë është.

Me këto dy nene të Kushtetutës, pakicat janë shumicë domosdo, sepse Kushtetuta i sanksionon të jenë në shumicën parlamentare edhe në shumicën qeveritare. Domethënë, ato që quhen "universalitete demokratike" këtu nuk funksionojnë, sepse të tilla si lë Kushtetuta dhe unë votoj që sot, që këto dy nene të Kushtetutës të ndryshohen.

Çfarë dua të them?

Se ne kemi Parlament që udhëheq shumica, kryetar dhe një nënkryetar kushtimisht, opozita një nënkryetar formal. Po kjo nuk ndodh këtu, sepse sanksionohen - edhe zgjedhjet; - edhe përfaqësimi; - edhe udhëheqësia politike, me Kushtetutë.

Patjetër në leximin e dytë edhe hartuesit do t'i kthehen këtij problemi, se s'mund t'i ikin.

- Çështja e dytë është :- unë propozoj që tek pjesa e komisionit, të formohet Komisioni Kushtetues i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nuk dua t'i elaboroj sot arsyet, arsyet janë multi, edhe kushtetuese te ne sot edhe çka na pret politikisht në të ardhmen.

Kuvendi duhet ta ketë komisionin e përhershëm kushtetues, në krye të cilit rrinë normalisht kryetari i Parlamentit, si në çdo Parlament. Të ketë numër përfaqësimi. Le të merren vesh partitë për formatin, sepse, ne nuk mund të shkojmë më tej, pa një komision të tillë.

Ka edhe probleme të tilla, të cilat janë definuar. psh. Problemi kryetarit të shtetit.

Unë e di, se merakun ka qenë për ti rregulluar të gjitha problemet, por s'mund t'i rregulloni, sepse ne nuk e dimë ende raportin kushtetues të kryetarit të ri - me Kuvendin. Pra, janë pikëpyetje të mëdha këto, kot shkruhen këtu si hipoteza.

Raporti i kryetarit të ardhshëm me Kuvendin nuk dihet

sepse ne s'kemi votuar ende amendamente për raportin, që do të ketë Kuvendi me atë kryetar, kushdo qoftë.

Dhe unë po ndalem këtu, duke theksuar që - të shihen nenet 64, 67 të Kushtetutës, - ndihet nevoja e formimit të Komisionit Kushtetues të Kuvendit.

Kryetari i Kuvendit, z. Jakup KRASNIQI

Unë falënderoj deputetin Sabri Hamiti, i cili tha se duhet të jetë në rregullore, por realisht do të duhej të ishte edhe në Kushtetutë, që Komisioni Kushtetues duhet të jetë i përhershëm dhe e drejton kryetari i Parlamentit. Unë jam kësaj radhe, nesër mund të jetë dikush tjetër. Konsideroj që ky komision duhet të udhëhiqet nga kryetari i Kuvendit.

Ajo që kemi miratuar edhe në seancat e para të vitit që kemi lënë pas, për një komision ad hoc, realisht bie ndesh krejt me Kushtetutën.

Neni 144 i Kushtetutës e saktëson se kush ka të drejtë të japë amendamentin kushtetues.

Janë 30 deputetë, - ¼ e deputetëve, - kryeministri dhe presidenti ose presidentja.

Edhe shtesa, që i është dhënë këtij komisioni, mendoj se nuk është në përputhje me Kushtetutën, sepse ata që kanë menduar të bëjnë amendamente të

Kushtetutës, u është dashur të mendojnë për amendamente në tërësi dhe jo pjesërisht. Formimi i këtij komisioni, siç duket, ka qenë "sui generis", por megjithatë është momenti, që Kuvendi të mos bëhet pjesë e shkeljeve të praktikave, në fund të fundit, se si bëhen amendamente të Kushtetutës, sepse ka edhe disa procedura tjera.

- Një çështje që dua ta trajtoj; - është çështja e komisioneve. Sigurisht, që duhet një harmonizim ndoshta më i mirë dhe një ndarje më e mirë e punëve në komisione. Kuvendi ynë ka 120 deputetë dhe formimi i shumë komisioneve, realisht i bën komisionet jo funksionale edhe për shkak të numrit të kufizuar të deputetëve, prandaj mendoj që këtu duhet ta shfrytëzojmë këtë mandat, që e kemi si Kuvend, për të ardhur në përfundimin, se sa komisione i duhen këtij Kuvendi dhe sigurisht, duhet

të kihet parasysh edhe kostoja buxhetore e komisioneve. Është në përgjegjësinë tonë si deputetë, të mendojmë.

- Problemin e Rregullores, nuk duhet ta shohim pozitë-opozitë, sepse dikush sot është opozitë e nesër mund të jenë pozitë dhe e kundërta. Qëllimi i punës tonë duhet të jetë, ta bëjmë një Rregullore të Kuvendit, e cila bën funksionale punën e Kuvendit. Nganjëherë me disa praktika, që i kemi vendosur, unë druaj se ne me punën tonë po e bëjmë jofunksionale punën që duhet ta kryej Kuvendi si institucion përfaqësues, ligjvënës dhe monitorues.

- Një çështje, të cilën mendoj se duhet ta shikojmë mirë, është çështja e kryesisë. Kryesia e Kuvendit tonë nuk mund të krahasohet me ato kuvende, që kanë në kryesi, - kryetarin, një nënkryetar i pozitës dhe një i opozitës. Ndaj, duhet parë se mbi cilën bazë ose me cilën praktikë është ndërtuar kryesia jonë e punës dhe ajo t'i qëndrojë konform asaj praktike. Gjithsesi, duhet parë edhe Kushtetuta, në nenet e saj, ku në një formë ose tjetër trajtojnë problemin e ndërtimit të Kryesisë së Kuvendit. Nëse duhet vërtet, që Konferenca e kryetarëve të grupeve parlamentare, të jetë më vendimmarrja në krijimin e rendit të ditës, duhet parë se a e lehtësojmë a e vështirësojmë vendimmarrjen?

Unë mendoj se e vështirësojmë, sepse duhet të ndjekim një praktikë, e cila është praktika që nuk krijon kriza. Nëse zgjedhim konferencën që është propozuar, atëherë duhet të zbatojmë praktikën slovene, të cilën e konsideroj se është një prej praktikave më të mira, e cila nuk e pengon punën e Kuvendit. Atje, përfaqësuesit e grupeve parlamentare janë aq të fuqishëm, sa është fuqia e grupit parlamentar dhe pastaj zgjidhet me votim. Në Kuvendin tonë, deri tani mbledhjet plenare janë organizuar me konsensus të plotë.

Por duhet të kemi kujdes, sepse kur e sanksionon në mënyrë taksative vendimmarrjen, mos sanksionimi që bëhet, e vështirëson vendimmarrjen dhe pastaj krijon disharmoni. Ndaj Kushtetuta dhe Rregullorja e Punës, duhet të jenë në përputhje të plotë dhe ta bëjnë sa më funksionale dhe sa më demokratike punën e Kuvendit

- Çështje tjetër që dua të trajtoj është;- Pyetjet parlamentare dhe Deklarimet jashtë rendit të ditës. Mendimi im është, se në deklarimet jashtë rendit të ditës, më shumë të diskutohet për çështje të cilat mund të hyjnë në rend të ditës, se sa për çështje, që nuk do të mund të hynin në rend të ditës. Në fund të fundit, kjo është përgjegjësia e secilit deputetë veç e veç, por ndoshta duhet parë mundësia për ta lehtësuar punën e seancave, ku miratohen ligjet. E për ta lehtësuar punën dhe ta bëjmë sa më funksionale punën e seancave, (mbledhjeve plenare ku miratohen ligjet), pyetjet parlamentare t'i lëmë dy herë apo qoftë edhe një herë në muaj. Nëse mbesin një herë në muaj, atëherë të shtohet koha. Sipas praktikave parlamentare, kur bëhen pyetjet

parlamentare dhe deklarimet jashtë rendit të ditës, nuk është e thënë të jetë prezenca e deputetëve të tjerë të cilët s'janë të interesuar të jenë pjesë e pyetjeve parlamentare dhe të deklarimeve jashtë rendit të ditës, sepse në fund të fundit edhe pyetjet parlamentare edhe deklarimet jashtë rendit të ditës, më tepër është një komunikim i deputetëve dhe i Kuvendit si trup me opinionin, se sa është me punën tonë brendapërbrenda.

Ajo që e kam parë në praktikat parlamentare, të cilat kanë edhe 400, 500 e ndoshta më tepër deputetë, në pyetjet parlamentare dhe deklarimet jashtë rendit të ditës, marrin pjesë një numër i kufizuar i deputetëve. Kështu mendoj se mund ta bëjmë më të lehtë dhe më funksionale punën e Kuvendit edhe punën e komisioneve edhe punën e grupeve parlamentare. Është e pamundur ta bëjmë një rregullore të punës të përkryer, por defektet që i kemi hasur gjatë këtyre viteve, është mirë t'i eliminojmë.

Me këto dy nene të Kushtetutës, pakicat janë shumicë domosdo, sepse Kushtetuta i sanksionon të jenë në shumicën parlamentare edhe në shumicën qeveritare. Domethënë, ato që quhen "universalitete demokratike" këtu nuk funksionojnë, sepse të tilla si lë Kushtetuta dhe unë votoj që sot, që këto dy nene të Kushtetutës të ndryshohen. Çfarë dua të them?

Se ne kemi Parlament që udhëheq shumica, kryetar dhe një nënkryetar kushtimisht, opozita një nënkryetar formal. Po kjo nuk ndodh këtu, sepse sanksionohen - edhe zgjedhjet;- edhe përfaqësimi ; - edhe udhëheqësia politike, me Kushtetutë.

Patjetër në leximin e dytë edhe hartuesit do t'i kthehen këtij problemi, se s'mund t'i ikin.

- Çështja e dytë është :- unë propozoj që tek pjesa e komisionit, të formohet Komisioni Kushtetues i Kuvendit të Republikës së Kosovës. Nuk dua t'i elaboroj sot arsyet, arsyet janë multi, edhe kushtetuese te ne sot edhe çka na pret politikisht në të ardhmen.

Kuvendi duhet ta ketë komisionin e përhershëm kushtetues, në krye të cilit rrinë normalisht kryetari i Parlamentit, si në çdo Parlament. Të ketë numër përfaqësimi. Le të merren vesh partitë për formatin, sepse, ne nuk mund të shkojmë më tej, pa një komision të tillë.

Ka edhe probleme të tilla, të cilat janë definuar. psh. Problemi kryetarit të shtetit.

Unë e di, se merakun ka qenë për ti rregulluar të gjitha problemet, por s'mund t'i rregulloni, sepse ne nuk e dimë ende raportin kushtetues të kryetarit të ri - me Kuvendin. Pra, janë pikëpyetje të mëdha këto, kot shkruhen këtu si hipoteza.

Raporti i kryetarit të ardhshëm me Kuvendin nuk dihet sepse ne s'kemi votuar ende amendamente për raportin, që do të ketë Kuvendi me atë kryetar, kushdo qoftë.

Dhe unë po ndalem këtu, duke theksuar që - të shihen nenet 64, 67 të Kushtetutës, - ndihet nevoja e formimit të Komisionit Kushtetues të Kuvendit.

Mblidhet Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit

Shoqëria kosovare dhe institucionet e Kosovës gjatë këtyre viteve nuk kanë arritur të luftojnë në shkallën e duhur asnjë formë të krimit organizuar



Këshilli Kombëtar Kundër Korrupsionit

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, mori pjesë në mbledhjen inauguruese të Këshillit Kombëtar Kundër Korrupsionit, e cila u mbajt nën drejtimin e presidentes së Republikës së Kosovës, Atifete Jahjaga

Me këtë rast kryekuvendari Krasniqi tha: "Jemi të vetëdijshëm se shoqëria jonë është shoqëri e re, institucionet që kemi ndërtuar janë të reja, ndaj ato kanë nevojë për mbështetje institucionale dhe nga shoqëria civile në përgjithësi.

Kuvendi i Republikës së Kosovës gjatë këtyre viteve, si institucion përfaqësues i qytetarëve të Kosovës, si institucion ligjvënës dhe mbikëqyrës i trupave të pavarura që ka zgjedhur, përfshirë edhe ekzekutivin, gjatë këtyre viteve, ka miratuar pos Kushtetutës, si akti më i lartë juridik për funksionimin e shtetit dhe institucioneve të tij edhe një infrastrukturë të gjerë ligjore, për t'i luftuar dukuritë negative të shoqërisë në tranzicion. Si institucioni më i lartë ligjvënës, kemi kontribuar me infrastrukturë ligjore në ndërtimin e institucioneve të pavarura dhe kushtetuese, që kanë për obligim t'i luftojnë dukuritë negative të shoqërisë dhe t'i bëjnë institucionet sa më funksionale. Janë institucionet tjera që kanë për obligim të zbatojnë ligjet që i miratojmë në Kuvend.

Jemi të vetëdijshëm se institucionet që kemi ndërtuar, ende nuk janë funksionalizuar për t'i kryer detyrat e tyre konform Kushtetutës dhe ligjeve të miratuara. Si duket, këto institucione

kanë nevojë edhe për institucione mbështetëse dhe këshillëdhënëse, siç është ky Këshill Kombëtar Kundër Korrupsionit, i cili po konstituohet sot.

Për hir të së vërtetës duhet të themi se shoqëria kosovare dhe institucionet e Kosovës gjatë këtyre viteve nuk kanë arritur të luftojnë në shkallën e duhur, asnjë formë të krimit organizuar, sepse nuk është vetëm korrupsioni në shoqërinë e Kosovës, i cili është duke e penguar zhvillimin demokratik dhe ekonomik të këtij vendi, por edhe mosluftimi i krimeve të ndryshme të organizuara edhe të sferës politike edhe të sferës ekonomike, që realisht janë duke e penguar shtetin tonë të ri, për të ecur përpara në rrugën e demokratizimit, të zhvillimit dhe të integriteteve.

Prandaj, si Kuvend, edhe një herë e themi me këtë rast, se do të jemi të gatshëm të miratojmë, çdo infrastrukturë ligjore, që i funksionalizon institucionet e pavarura të shtetit, e në mënyrë të veçantë segmentin e drejtësisë, të cilin e konsiderojmë, se ka pasur shenja të dobësisë në luftë kundër dukurive që sot janë në shoqërinë e tonë. Unë dëshiroj që ky Këshill Kombëtar vërtet të japë këshilla dhe të ndihmojë institucionet kushtetuese dhe ato të pavarura, që kanë përgjegjësi kushtetuese dhe ligjore për të luftuar këto dukuri, apo këtë fenomen të shoqërive në përgjithësi, e të shoqërisë kosovare në veçanti.

Komisioni për Buxhet dhe Financa ka mbajtur dëgjim publik për Projektligjin për bankat, institucionet mikro financiare dhe institucionet financiare jo bankare

Projektligji avancon sektorin bankar në Kosovë

Projektligji ka për qëllim ndërtimin e një infrastrukture moderne ligjore për licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, institucioneve mikro financiare dhe institucioneve financiare jo bankare



Pamje nga degjimi publik

Në vazhden e punës për shqyrtimin dhe amendamentin e Projektligjit për bankat, institucionet mikro financiare dhe institucionet financiare jo bankare, Komisioni për Buxhet dhe Financa i Kuvendit të Republikës së Kosovës, i kryesuar nga Safete Hadërgjonaj, më 8 shkurt 2012, ka mbajtur dëgjim publik, në të cilin ishin të pranishëm përfaqësues të Qeverisë së Kosovës, Bankës Qendrore të Kosovës (BQK), të bankave, organizatave joqeveritare dhe ekspertë të tjerë.

Kryetarja e komisionit, znj. Hadërgjonaj, dha një pasqyrë të ecurisë së këtij projektligji deri në fazën e amendamenteve, në funksion të të cilit ishte edhe ky dëgjim publik. Duke e potencuar rëndësinë e këtij projektligji, Hadërgjonaj tha se fusha të cilën ai e mbulon, deri tani nuk ka qenë e rregulluar me ligj. Sistemi bankar i Kosovës dhe veprimtaria e institucioneve mikro- financiare, kanë qenë të rregulluara me rregullore të UNMIK-ut, ndërsa institucionet jo bankare, me rregulla të Bankës Qendrore.

“Meqenëse ky projektligj rregullon një sferë të rëndësishme që reflekton në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe stabilitetit të sektorit financiar, Komisioni për Buxhet dhe Financa e ka parë të arsyeshme të organizojë këtë dëgjim publik, që t’iu mundësohet të gjithë të interesuarve të ofrojnë vërejtjet dhe rekomandimet e tyre, në mënyrë që komisioni ta ketë mundësinë të bëjë ndryshim-plotësimet e

nevojshme në projektligj, që kjo fushë të rregullohet sa më mirë, ndërsa ligji të jetë sa më i zbatueshëm në praktikë”, theksoi kryetarja Hadërgjonaj.

Në vazhdim, ajo shtoi se me këtë projektligj përmirësohen standardet e qeverisjes së bankave, krijohet mundësia për një mbikëqyrje më të mirë të institucioneve bankare, institucioneve mikro-financiare dhe institucioneve financiare jo bankare, si dhe është përcaktuar mënyra e licencimit, gjë që, sipas saj, e ngrit nivelin e sigurisë e të stabilitetit financiar në vend dhe siguron një nivel më të përshtatshëm të mbrojtjes së depozitave.

Sipas Hadërgjonajt, projektligji përcakton, gjithashtu, edhe veprimtarinë e institucioneve mikro- financiare dhe institucioneve jo bankare financiare, si dhe definon kornizën për regjistrimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e tyre.

“Meqenëse ky projektligj ka bërë avancimin e këtij sektori të rëndësishëm për ekonomin tonë, i është përafëruar direktivave të BE-së dhe standardeve ndërkombëtare, komisioni e ka mirëpritur atë dhe është i angazhuar të shqyrtojë kujdesshëm çdo vërejtje dhe rekomandim të deputetëve në seancën plenare, si dhe do të analizojë të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet e juaja në këtë dëgjim publik”, u shpreh kryetarja Hadërgjonaj.



Pamje nga degjimi publik

Ministri i Financave, Bedri Hamza, duke e prezantuar ligjin, theksoi se gjatë hartimit të tij, janë marrë parasysh standardet më të mira ndërkombëtare, standardet dhe direktivat e BE-së në fushën e mbikëqyrjes e të rregullimit bankar, si dhe parimet bazë të Bazelit për mbikëqyrje efektive bankare. Sipas Hamzës, zhvillimi i sistemit bankar gjatë dhjetë viteve të fundit në Kosovë dhe ndryshimet në praktikën e mbikëqyrjes bankare, kanë rritur kërkesën për nxjerrjen e ligjit të ri për bankat, institucionet mikro- financiare dhe institucionet e tjera financiare jo bankare, me qëllim të reflektimit të ndryshimeve që kanë ndodhur nga viti 1999 deri më tash.

“Ligji do të mbulojë përveç bankave komerciale edhe institucionet mikro financiare dhe ato financiare jo bankare. Ligji përmirëson standardet e qeverisjes së bankave. Dispozitat e tij i japin autoritet Bankës Qendrore të ndërmarrë masa përmirësuese si dhe të vendosë gjyba administrative për shkelje të ndryshme të ligjit, me qëllim të forcimit të stabilitetit financiar në vend”, tha ministri Hamza.

Sa i përket institucioneve mikro- financiare, ai tha se ligji përcakton një strukturë të përcaktuar qartë të pronësisë dhe njëkohësisht eliminon paqartësitë ekzistuese në drejtim të institucioneve mikro- financiare dhe atyre jo bankare.

“Në përgjithësi, ky ligj ka për qëllim ndërtimin e një infrastrukture moderne ligjore për

licencimin, mbikëqyrjen dhe rregullimin e bankave, institucioneve mikro-financiare dhe institucioneve financiare jo bankare, duke siguruar objektivin e saj kryesor për avancimin e një sistemi bankar e financiar, të shëndoshë e stabël, si dhe sigurimin e një niveli të përshtatshëm mbrojtës të interesave të depozitorëve”, u shpreh Hamza.

Guvernatori i BQK-së, Gani Gërguri, përmendi një varg risish që projektligji sjell në këtë fushë, ndërsa theksoi se risia kryesore ka të bëjë me forcimin e kriterëve të qeverisjes, si nevojë aktuale për bankat dhe institucionet financiare në Kosovë.

Anëtarët e tjerë të Bordit të BQK-së, Mejdi Bektashi e Sejdi Rexhepi, ekspertët, përfaqësuesit e bankave, të institucioneve të tjera e të shoqërisë civile, i bënë një elaborim të detajuar projektligjit, dhanë vërejtje dhe sugjerime për rregullimin pjesëve të caktuara të tij. Duke e cilësuar si ligj shumë të domosdoshëm për vendin, diskutuesit zhvilluan një debat të gjerë duke potencuar mangësitë e projektligjit dhe duke mëtuar të japin zgjidhjet adekuate për përmirësimin e tij.

Kryetarja e komisionit, Hadërgjonaj, vërejtjet e diskutuesve i konsideroi të rëndësishme dhe theksoi se komisioni, gjatë amendamenteve të projektligjit, do t'i marrë ato parasysh dhe do t'i trajtojë seriozisht.

Shuhet Gjeneralmajor, Shaban Shala



Fjala e kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi,



E nderuar familje Shala,
Të nderuar pjesëmarrës,
Zonja dhe zotërinj

Po ndahemi nga miku dhe vëllai ynë i shtrenjtë, atdhetari i shquar Shaban Shala. Ai vdiq papritur dhe tepër herët, duke qenë në krye të detyrës në shërbim të popullit dhe vendit të vet. Kosova e humbi sot një nga bijtë e saj besnik dhe luftëtar të paepur gjatë gjithë jetës së tij. I lindur më 1 dhjetor 1958 në Negroc të Drenasit nga nënë Taibja dhe babë Velju, Shabani i vogël po edukohet në frymën patriotike dhe me traditën e rezistencës së pashuar të Drenicës së tij legjendare. Ai mori mësimet e para në vendlindje, mbaroi shkollimin e mesëm në Kijevë dhe Fakultetin Juridik në Prishtinë.

Që në moshë të re, Shaban Shala hyri në radhët e gjata të militantëve ilegalë të Lëvizjes sonë kombëtare, duke qenë i bindur, jo vetëm në drejtësinë e luftës dhe të idealeve që përfaqësonte, por edhe për kurorëzimin me fitore të sigurt, të rrugës së vështirë e plot sakrifica, që kishte nisur ai dhe brezi i tij. Pas demonstratave historike të vitit 1981, në të cilat Shaban Shala, mori pjesë aktive, Lëvizja jonë ndiqej e goditej egërsisht nga regjimi pushtues, me qëllim të zhdukjes së çdo vatre të rezistencës dhe të mposhtjes së popullit shqiptar në përpjekjet për liri, barazi dhe bashkim kombëtar.

Pas burgimit disamujsh gjatë demonstratave, bashkë me Rexhep Malajn, Nuhi Berishën, Fehmi Lladrovcin, Hafir Shalën dhe qindra veprimtarë të tjerë të vendosur, Shaban Shala iu bë digë fushatës shoviniste kundër popullit shqiptar dhe

Lëvizjes së tij kombëtare. Ata ripërtërinë radhët e rezistencës, duke i zgjeruar ato dhe duke e avancuar organizimin ilegal, drejt luftës së armatosur.



Ashtu si Kadri Zekën e vëllezërit Gërvalla më 1982, pushtuesit vranë në vitet vijuese edhe Rexhep Malajn, Nuhi Berishën, Bajram Bahtirin e veprimtarë të tjerë, kurse Shaban Shalën me shumë shokë e arrestojnë në tetor të vitit 1985, për ta dënuar me 9 vjet burgim. Qëndrimi i tij stoik në hetuesi, shpëtoi shumë veprimtarë pa u arrestuar dhe ruajti vazhdimësinë e organizimit të Lëvizjes në Kosovë dhe jashtë saj.

Kur mori vesh që njëri nga ushtarët mbante emrin e tij, Aleksandri i Madh iu afrua dhe i tha, nëse të pëlqen mbaje emrin tim, por duhet të jesh Aleksandër! Shaban Shala i ri e mbajti me nder emrin e Shaban Shalës së vjetër, veprimtarit të

shquar të Kosovës, të cilin e kishin mbytur në burg katilët e UDB-së.

Unë kam pasur fatin të jem në Burgun e Novi Sadit bashkë me Shaban Shalën. Shumë vite na mbanin të izoluar nga bashkëvuajtësit shqiptarë, por nga fundi i dënimit, u bëmë bashkë disa të burgosur. Kolegët e Lëvizjes në burg e mbajnë mend Shaban Shalën për virtytet e tij të larta, për guximin e moralin e pathyeshëm, për pasionin për librin dhe dijen, për qartësinë vizionare dhe vendosmërinë, për dashurinë dhe kujdesin për shokët dhe për frymën e sakrificës e të vetëmohimit.



Besnik i idealeve të tij e të shokëve të rënë, Shaban Shala, me të mbajtur burgun, vazhdon veprimtarinë atdhetare, fillimisht në Këshillin për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut dhe qysh në orët e para bëhet njëri nga organizatorët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Bashkë me të vëllanë, Bedri Shala, i rënë dëshmor me armë në dorë, ata ishin luftëtarë dhe drejtues të lartë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Pas çlirimit, gjeneralmajori Shaban Shala,

vazhdon kontributin e tij, tashti ushtarak në organizimin e TMK dhe të Ushtrisë së ardhshme të Kosovës.

Shaban Shala ishte në krye të detyrës dhe në moshën më produktive. Ai i duhej edhe sot e nesër Kosovës, të cilën aq shumë e deshi dhe aq shumë bëri për të.

Humbjen e veprimtarit të madh, Shaban Shala do ta ndjejmë gjatë, por kujtimi i lavdishëm për të do të jetë i pavdekshëm.

8 Marsi - Në Kuvendin e Republikës së Kosovës

Me kërkesën e Grupit të Grave Deputete, mbështetur me 44 nënshkrime deputetësh të të gjitha grupeve parlamentare dhe të të gjitha nacionaliteteve, Kuvendi i Republikës së Kosovës ka mbajtur sot një mbledhje të veçantë plenare, për të debatuar për pozitën e gruas në shoqërinë e Kosovës.



Që në fillim të mbledhjes plenare, të drejtuar nga dr. Jakup Krasniqi, (një pjesë të saj e ka drejtuar nënkryetari i Kuvendit, dr. Sabri Hamiti), kryetarja e Grupit të Grave deputete, Teuta Sahatqija ka arsyetuar kërkesën për këtë seancë, si dhe ka paraqitur rekomandimet, të cilat, të begatuara gjatë debatit parlamentar, ka kërkuar të miratohen në përfundim të mbledhjes së sotme plenare.



Debatin e ka hapur kryetarja e Komisionit për të Drejtat e Njeriut, Barazi Gjinore, Persona të pagjetur dhe Petecione, Suzana Novoberdali, e cila ka theksuar rolin shumë të rëndësishëm të gruas gjatë gjithë historisë njerëzore, si dhe rolin e gruas në shoqërinë e sotme të Kosovës. Ajo ka lavdëruar rregullimin normativ të pozitës së gruas në shoqërinë tonë, duke e lavdëruar edhe përfaqësimin e saj në institucionet shtetërore të Kosovës, por ka pohuar se realizimi të drejtave të gruas në praktikë has në shumë pengesa.



Në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së ka folur Blerta Deliu- Kodra, e cila ka përmendur miratimin e ligjeve që kanë të bëjnë me barazinë gjinore: Ligjin për punën, atë për Barazinë gjinore dhe Ligjin kundër diskriminimit, duke pohuar se kusht për integrimin evropian të Kosovës do të jetë edhe niveli i mirë i realizimit të barazisë gjinore.

Kryetari i Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, ka përshëndetur këtë nismë për debat parlamentar për pozitën e gruas në shoqërinë e Kosovës, si dhe punën e madhe që po bën Grupi i Grave Deputete. Të drejtat e gruas i ka quajtur fundamentale për një shoqëri të emancipuar, kurse arsimimin e gruas e ka vlerësuar kusht të krijimit të një shoqërie të zhvilluar demokratike.



Dje, me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Gruas, në Prishtinë është mbajtur një protestë e grave - viktimat të dhunës serbe, ka theksuar Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar Vetëvendosje! Duke i vlerësuar viktimat "gra pa zë", ajo ka kërkuar që ato të mbështeten gjithanshëm nga shoqëria dhe institucionet, përfshirë edhe kërkim shpagimi për traumat e pësuar nga ushtarë dhe paramilitarë serbë.

Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, ka theksuar se barazia gjinore nuk realizohet me lutje e ankesa, por me Kushtetutë dhe me ligje. Duhet të ofrojmë mundësi që grua të ndjehet e barabartë, ka thënë ai, duke kërkuar që Inspektorati i Punës të hetojë rregullisht zbatimin e Ligjit për punën, sidomos kur ka të bëjë me gratë.



Gruaja së pari duhet të ndjehet e barabartë në familje, ka thënë deputetja Myzejrene Selmani në emër të KKR-së, duke shtuar se vetëm atëherë krijohen premisa të mira edhe për barazi në të gjithë lëmenjtë e tjerë të jetës.



Duke folur në emër të Grupit Parlamentar 6+, Myfera Shenik, është ndalur në rëndësinë historike dhe aktuale të 8 Marsit, si ditë Ndërkombëtare e Gruas. Duke kremtuar këtë ditë, ka thënë ajo, duhet të mendojmë sa janë gratë të barabarta në aspektin gjinor, dhe sa janë të përfaqësuara në arsim, shëndetësi, ekonomi, jetë shoqërore dhe në politikë.

Nënkryetari i Kuvendit, Sabri Hamiti, domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërgjinor e ka ilustruar me veprat e suksesshme artistike, si këngën "Baresha" të Rexho Mulliqit dhe Nexhmie Pagarushës, me dramën "Erveheja" të regjisorit Muharrem Qena dhe aktore Melihate Ajetit dhe me një spektër të gjerë krijuesish nga artet, kultura, sportet etj.



Pamje nga sallja

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Jakup Krasniqi, temën e debatit e ka vlerësuar të ndjeshme, jo vetëm për vendin tonë, duke shtruar pyetjet: Çka ka mund të bëjmë për gruan? Çka duhet ndryshojmë në planin e të drejtave të grave në Kosovë? Si të përgatitemi të avancojmë në këtë plan? etj. Ai ka përkujtuar se Kuvendi kohë më parë ka miratuar një rezolutë në mbështetje të Objektivave Zhvillimore të Mijëvjeçarit. Ai ka mbajtur qëndrim që me realizimin e të drejtave të gruas duhet të fillohet me edukatën në familje, si dhe është angazhuar për një arsim cilësor, i cili do të krijojë gjenerata të reja me integritet. Në vazhdim është zhvilluar debat i gjerë parlamentar lidhur me pozitën e gruas në shoqërinë e Kosovës. Një pjesë e diskutuesve, ndërkaq, kanë përmendur lista të gjata të grave që kanë lënë gjurmë në historinë e gjatë të shqiptarëve.

Deputeti nga radhët e Lëvizjes për Bashkim, Agim Kuleta, pasi e ka përmbyllur fjalën e tij në këtë debat, në shenjë nderimi dhe respekti për kontributin e grave deputete, kryetares së GGD-së, Teuta Sahatqija, i ka dhuruar një buqetë lulesh të freskëta.

Në përfundim të seancës deputetët kanë miratuar rekomandimet për forcimin e pozitës së gruas në Kosovë, të cilat do të publikohen pasi të nënshkruhen nga kryetari i Kuvendit.

Alternativat e energjisë në Kosovë

Kornizë gjithëpërfshirëse për koncesione dhe privatizim për investitorët privatë strategjikë Kuvendi, Qeveria dhe institucionet përkatëse për sektorin e energjisë do të avancojnë një numër reformash dhe strategjish

Kryetari i Kuvendit të Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, mori sot pjesë në konferencën me temën: Alternativat Energjetike në Kosovë, organizuar nga Instituti për Politika Zhvillimore (INDEP). Me këtë rast ai mbajti këtë fjalë rasti: "Paraprakisht më lejoni të shpreh konsideratën time të veçantë për angazhimet tuaja mbi identifikimin e sfidave dhe mundësive alternative të prodhimit të energjisë elektrike në Kosovë. Pres që kjo konferencë përveç që do të trajtojë njërin nga

gështjet mjaft të rëndësishme, si burimet e ripërtëritshme të energjisë, të rezultojë dhe me rekomandime që do të inkurajonin investimet private në sektorin e energjisë.

Energjia është sektor kyç për ekonominë e Kosovës, veçanërisht për shkak të potencialeve të mëdha të burimeve të linjitit që ka vendi ynë. Sipas skenarëve aktualë, sektori energjetik te ne është i dominuar nga KEK-u. Pothuajse 90% e prodhimit të energjisë është nga djegia e linjitit.



Pamje nga konferenca

Procesi i reformimit dhe ristrukturimit në këtë sektor po kalon nëpër shumë vështirësi, duke dështuar kështu së paku deri më tani, të përmbushë caqet e vëna nga Strategjia për energji dhe legjislacioni vendor e ndërkombëtar. Edhe për lundër subvencioneve të mëdha ndërkombëtare dhe nga buxheti i Kosovës, të dedikuara në këto dhjetë vitet e fundit KEK-ut, megjithatë ai nuk ka arritur të sigurojë performancë të cilësuar, e cila do të garantonte se kjo korporatë do të jetë e vetëqëndrueshme financiarisht dhe të garantojë ristrukturim rrënjësor, i cili do të

përmbushte kushtet e vëna nga Direktiva e BE-së. Sipas kësaj gjendjeje ende vazhdon risku i furnizimit permanent me energji elektrike, eksploatimi joracional i burimeve energjetike dhe mospërmbushje e konditave mjedisore. Eksperienca nga vendet e zhvilluara ka treguar se zhvillimi i qëndrueshëm ekonomik është i mundur vetëm pas vendosjes së drejtë të marrëdhënieve në mes të shfrytëzimit racional të resurseve natyrore, në njërin anë dhe rritjes ekonomike e qëndrueshmërisë mjedisore, në anën tjetër.



Kosova paraqet një vend me konsum mesatar të energjisë për banor. Të gjitha parashikimet mbi rritjen ekonomike rezultojnë se do të ketë një rritje të lartë të kërkesës për energji, e të cilat me këtë gjendje të sektorit nuk ka mundësi të përmbushën nga prodhimi vendor. Në këtë kontekst, zhvillimi i kapaciteteve të reja gjeneruese, përfshirë këtu edhe energjinë nga burimet alternative, do të ndikonte në përmirësimin e furnizimit me energji, do të zvogëlonte vartësinë nga importi i energjisë dhe do të rriste mundësitë për përmbushjen e caqeve të Strategjisë.

Kosova synon integrimin në BE. Andaj jemi të vetëdijshëm që ky proces, përveç që kërkon reformim dhe ristrukturim të thellë të sektorit energjetik, njëkohësisht kërkon edhe një qasje të re prodhuese e cila do të garantonte në masën 20% zvogëlim të emetimit të gazrave (efekti sere), 20% rritje të pjesëmarrjes së burimeve të ripërtëritshme në konsumin total të energjisë dhe 20% përmirësimin e efikasitetit të energjisë. Këto çështje, jo vetëm që janë caqe të vëna sipas Traktatit të Komunitetit të Energjisë në Evropën Juglindore (në të cilën edhe Kosova është një nga palët kontraktuese), por do të duhej të konsiderohen edhe si objektiva strategjike për zhvillimin dhe ristrukturimin e sektorit të energjisë. Në këtë drejtim Kuvendi, Qeveria dhe institucionet adekuate për sektorin e energjisë do të avancojnë një numër reformash dhe strategjish

të cilat do të përfshinin:

Zhvillimin e kapaciteteve të reja gjeneruese të energjisë, përfshirë edhe burimet e ripërtëritshme;

Reformimin e sektorit energjetik, në përputhshmëri me kërkesat e Traktatit të Komunitetit të Energjisë;

Heqjen e monopolit dhe sigurimin e tregut të lirë;

Zhvillimin e një kornize gjithëpërfshirëse për koncesionet dhe privatizim për investitorët privatë strategjikë;

Promovim të efikasitetit të energjisë dhe investimeve private në projektet e energjisë nga burimet e ripërtëritshme;

Aplikimi i tarifave stimuluese, sidomos për energjinë nga burimet e ripërtëritshme dhe;

Promovimin e avantazheve që sjellin investimet në kapacitet nga burimet e ripërtëritshme të energjisë.

Duke konsideruar se potencialet e energjisë (diellore, hidrocentraleve, biomasës, mbetjeve urbane, etj.) edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të jenë të pashfrytëzuara dhe rëndësia që ato kanë në zhvillimin e sektorit energjetik, institucionet e Kosovës do të garantojnë kuadrin e plotë ligjor dhe rregullator, i cili do të promovonte këto, në burime afatgjate dhe të qëndrueshme për prodhim të energjisë dhe zhvillimin e gjithmbarshëm ekonomik.

Duke falënderuar organizatorët, Konferencës i uroj mbarëvajtje dhe sukses të plotë”, theksoi kryekuvendari Krasniqi.

Deputeti Shaip Muja, PDK

1- Për Ministrin e Ambientit dhe Planifikimit Hapësinor, z. Dardan Gashi

Kur ka qenë lajmërimi i parë i Ferro-nikelit dhe Sharcemit se janë duke shkelur ligjet në fuqi dhe cilat kanë qenë hapat që ju keni ndërmarrë në këtë drejtim për ti disiplinuar në respektim të këtyre ligjeve. Sa stafi juaj i ka marrë seriozisht propozimet dhe shqetësimet e miya që njëherazi janë edhe shqetësime të votuesve të mi dhe qytetarëve të Republikës së Kosovës.

2- Për Ministrin e Drejtësisë z. Hajredin Kuçi

Z. ministër, dua të di nga Ju, për një procedurë ligjore, se si duhet të procedohet dhe kur quhet kundërvajtje dhe kur quhet penale. Kompanitë e lartë përmendura, disa herë kanë pasur vërejtje nga institucionet për shkeljen e kontratave të lidhura dhe respektimin e ligjeve e rregulloreve në fuqi për çështjen e shfrytëzimit dhe mbrojtjen e ambientit .

Së fundit Ferro-nikeli gjohet për të dytën herë me kundërvajtje. Kjo për mua nuk i takon këtij dënimi, por tashmë është një çështje e lartë penale, e cila është e prekur edhe në raportin e progresit për mosrespektimin e ligjeve dhe normave ambientale në fuqi.

3- Për Ministrin e Shëndetësisë z. Ferid Agani

Z. ministër, dua të di nga Ju se çfarë hapash keni ndërmarrë për të evidentuar sëmundjet që shkaktohen për këtë popullatë, e cila është e ekspozuar drejtpërdrejtë këtij dëmtimi ambiental, nga Ferronikelit dhe Sharcemi?

Deputeti Lutfi Haziri, LDK

1-Për Ministrin e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, z. Memli Krasniqi

Cila është arsyeja e mos vazhdimit të fazës së dytë të punimeve në stadiumin e KF Prishtina?

Deputeti Liburn Aliu, VV

1- Për ministrin e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, z. Blerand Stavileci

A do të realizohet pagesa e plotë për blegtorët sipas premtimit që u është bërë për delet dhinë dhe lopët? Nëse do të realizohet kjo pagesë atëherë kur do të bëhet?

2- Për Ministrin e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor z. Dardan Gashi

Në raportin e Zyrës së Koordinatorit për Strategjinë e Veriut, 2011(faqja 28-29) thuhet se strukturat ilegale të Serbisë kanë një plan që gjatë këtij viti ta themelojnë një kompani të ndarë të ujësjellësit që do të lidhet me liqenin e Ujëmanit. “ Lokacioni kryesor i i fabrikës së ujit për Mitrovicën është në jug të qytetit dhe pretendimet e kësaj organizate (Vodovod Ibar) janë që të ndërtohet një fabrikë e ujit e ndarë nga pjesa tjetër e atij që ekziston, duke mos pasur asnjë lidhje me jugun e qyteti. Ky projekt është paraqitur prej kohësh dhe pritet që një pjesë të financohet nga Qeveria e Serbisë dhe pjesa tjetër nga BE-ja, thuhet në këtë raport.

Çfarë masash janë marrë që të parandalohet kjo?

3- Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Kryeministri Thaçi asnjëherë nuk i ka demontuar këto të dhëna të WikiLeaks. Cilat ishin konkluzionet e takimeve?

Deputete Donika Kadaj - Bujupi, AAK

1- Për Kryeministrin e Republikës së Kosovës z. Hashim Thaçi

Raporti i Progresit edhe kësaj radhe është “raporti i ngecjes”, për Kosovën Nga eksperiencia Juaj, cilat janë arsyet?

2- Për Ministren e Tregtisë dhe Industrisë, znj. Mimoza Kusari – Lila

Raporti i Progresit edhe kësaj here thotë :- “ Kosova pa progres në fushën ekonomike. Ku mbeti “Plani i Banskos”?

Deputeti Arsim Bajrami PDK

Për Ministrin e Administratës Publike z. Mahir Jakxhilar

Z. Ministër: A mund të na informoni se në cilën fazë është procesi i hartimit të akteve nënligjore për zbatimin e ligjit për Shërbimin Civil.

Deputetja Kimete Bytyçi, LDK

Për Ministrin e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural z. Blerand Stavileci

Z. Ministër ; kërkoj nga ju që të më njoftoni, se cili është Planifikimi i MPBZHR-së, për subvencionimin e vreshtarëve të Therandës në mbjelljen e hardhive të reja të rrushit në këtë komunë, pas shkatërrimit të një pjesë për shkak të kalimit të autostradës Dr. Ibrahim Rugova?

Deputeti Daut Haradinaj, AAK

Për Ministrin e Forcës së Sigurisë së Kosovës, z. Agim Çeku

Kohëve të fundit është paralajmëruar largimi i rreth 100 oficerëve të FSK-së nga puna. Tash kontrata pune nuk kanë as oficerët dhe as ushtarët, që nga 20 janari 2012.

Mund të përgjigjeni për këtë fenomen jo të zakonshëm kur në mënyrë të pashpjeguar janë larguar dhe janë në procedurë të largimit oficerë të dalluar?

Deputetja Alma Lama VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Çfarë veprimesh ka ndërmarrë deri tani qeveria e Kosovës për kthimin e Fondit të privatizimit në Kosovë?

Deputeti Visar Ymeri VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Faqja e internetit, WikiLeaks, e cila prej kohësh po publikon kabllot diplomatike të ambasadave të SHBA-ës me Departamentin e shtetit amerikan,. WikiLeaks ka nxjerrë vitin e kaluar disa kabllot të cilat flasin për dy takime të cilat i keni pasur me Presidentin e Serbisë Tadiç. Takimi i parë, sipas kablllove , ka ndodhur në vitin 2006 në Selanik gjatë Konferencës së Internacionales Socialiste. Takimi i dytë ka ndodhur në Nju York, në selinë e OKB-së gjatë vitit 2008, kur ju ishit në cilësinë e Kryeministrit, e kani takuar Tadiçin.

Ku dhe kur është marrë vendimi që ju të takoheni me Tadiçin?

Deputeti Rexhep Selimi VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Çka ka fituar Kosova e çka ju nga këto takime?

Deputeti Glauk Konjufca VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Cila palë e ka marrë iniciativën për këto takime, ajo shqiptare apo ajo serbe? Cili ka qenë ndërmjetësuasi i takimit?

Deputetja Albulena Haxhiu, VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Kush tjetër ka marrë pjesë në këto takime dhe për çfarë keni biseduar. Çfarë ju ka thënë juve Tadiçi dhe çfarë i keni thënë ju atij?

Deputeti Afrim Kasolli VV

Për Kryeministrin e Kosovës, z. Hashim Thaçi

Cilët persona janë në dijeni të diskutimeve në keto takime? A janë raportuar diku këto takime, e nëse po , ku janë raportuar, e kush ka qenë raportuesi?

Takimet e Kryetarit të Kuvendit

Kryekuvendari Krasniqi, uron
presidentin e Parlamentit Evropian, z. Martin Schulz



Martin Schulz në momentin e zgjedhjes

I nderuar Zoti President,

Nëpërmjet kësaj letre Ju uroj për zemërsisht zgjedhjen në institucionin e lartë të Presidentit të Parlamentit Evropian, ju uroj sukses në përmbushjen e përgjegjësisë të mëdha në krye të këtij institucioni të lartë të Bashkimit Evropian.

Duke qenë alternativa e vetme dhe prioriteti ynë strategjik integrimi evropian dhe euroatlantik, ne presim nga Ju dhe nga gjithë miqtë tanë, të na mbështetni edhe në këtë proces historik dhe jetik për popullin e Kosovës, i cili do t'i sjellë në familjen e madhe të popujve evropianë vlerat e tij antike dhe moderne.

Duke vlerësuar lart marrëdhëniet e shkëlqyera midis Kuvendit të Kosovës dhe Parlamentit Evropian, shpreh bindjen që ato do të thellohen dhe zgjerohen në vazhdimësi. Me këtë rast, dëshiroj edhe njëherë t'ju siguroj për vullnetin dhe dëshirën tonë për bashkëpunim midis Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Parlamentit Evropian.

Shpresoj që në mandatin që keni do të gjeni kohë ta vizitoni Kosovën, për të cilën ka bërë dhe po bën aq shumë Bashkimi Evropian.

Ju lutem Shkëlqesi, pranoni shprehjen e konsideratës sime më të lartë”.

Michael Wood: Vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës është i drejtë.



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, pati një takim me z. Michael Wood, udhëheqës i grupit të mbrojtësve të Kosovës pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë. Me këtë rast, pos tjerash, z. Michael Wood, tha se vendimi i Gjykatës Ndërkombëtare të Hagës, sa i përket shpalljes së pavarësisë së Kosovës, ishte i drejtë. Kosova, tha ai, është rast sui generis dhe nuk mund të merret si precedent për raste të tjera.

Pasi e falënderoi z. Michael Wood për këtë vizitë, kryekuvendari Krasniqi i bëri një vështrim punës së Kuvendit të Kosovës, sidomos në fushën e legjislacionit. Në vijim kreu i legjislativit të vendit e vlerësoi punën e grupit të mbrojtësve të Kosovës pranë Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë, të kryesuar nga z. z. Michael Wood. Bashkëbiseduesit folën edhe lidhur me dialogun ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, si dhe për gjendjen në pjesën veriore të vendit.

Bumçi: “100-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, pa Kosovën e pavarur, nuk do të kishte rëndësinë dhe jehonën që i përket”



Koordinimi i aktiviteteve që kanë të bëjnë me 100-vjetorin e Pavarësisë së Shqipërisë ishte tema qendrore e takimit të kryetarit të Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, me ministrin e Kulturës së Shqipërisë, z. Aldo Bumçi. Pasi u falënderua për këtë pritje, z. Bumçi tha se 100-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë, pa Kosovën e pavarur, nuk do të kishte rëndësinë dhe jehonën që i përket. Në këtë frymë, ai theksoi se trashëgimia kulturore është një tërësi, ndërsa krijimi i hapësirave të bashkëpunimit ndërmjet Shqipërisë dhe Kosovës po sjell prurje të reja dhe të dobishme për kombin, në të gjithë lëmenjtë e jetës, e posaçërisht në rrjedhat kulturore.

Duke i shprehur mirëseardhje ministrit Bumçi, kryekuvendari Krasniqi theksoi se 100-vjetori i Pavarësisë së Shqipërisë hap një epokë të re për kombin shqiptar. Sa i përket çështjes së diasporës, bashkëbiseduesit ishin unik në konstatimin se pa marrë para sysh se nga vjen ajo, pra nga Kosova, Shqipëria, ose viset tjera shqiptare, ajo është një dhe ashtu duhet të trajtohet. Në këtë vështrim edhe qendrat kulturore që hapen nga Kosova në vende të ndryshme të botës duhet të jenë të përbashkëta. Bashkëbiseduesit u angazhuan për një zhvillim edhe me të thelluar të bashkëpunimit, në kontekst të shfrytëzimit të mundësive të favorshme që janë krijuar.

Samuel Zhbogar; "...bashkërisht duhet t'i bëjmë reformat për përshpejtimin e rrugës së integrimit të Kosovës drejt BE-së"



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, ka pritur sot përfaqësuesin special të BE-së, për Kosovën, Samuel Zhbogar, njëherësh kryesues i Zyrës Evropiane në Kosovë, me të cilin ka biseduar për zhvillimet në Kosovë, si dhe për forcimin e marrëdhënieve me BE-në dhe mekanizmat e saj në rrugën e Kosovës drejt integritimeve evropiane.

Përfaqësuesi i BE-së, për Kosovën, Samuel Zhbogar, ka shprehur kënaqësinë për takimin dhe për pritjen e ngrohtë që i është bërë nga institucionet, nga mediat dhe nga qytetarët e vendit tonë. "Ka shumë gjëra të rëndësishme që BE-ja dhe Kosova duan t'i bëjnë bashkë, prandaj bashkërisht duhet t'i bëjmë reformat për përshpejtimin e rrugës së integrimit të Kosovës drejt BE-së", ka theksuar Zhbogar, duke e vlerësuar në këtë mes shumë të rëndësishme mbështetjen nga Kuvendi i Kosovës të këtyre reformave dhe agjendës evropiane të vendit. Ai e ka vlerësuar të domosdoshëm bashkëpunimin sa më të mirë të Kuvendit të Kosovës me Parlamentin Evropian dhe me parlamentet e vendeve anëtare të BE-së edhe për faktin se ato do ta kenë fjalën kryesore për integrimin evropian të Kosovës.

Kryeparlamentari Krasniqi ka shprehur kënaqësinë që BE-ja ka ngritur

gatishmërinë për mbështetjen e Kosovës në rrugën drejt BE-së, ndërkaq emërimin e zotit Zhbogar në këtë post të rëndësishëm e vlerësoi si dëshmi të kësaj gatishmërie. Kreu i Kuvendit ka pohuar se Kuvendi i Kosovës edhe deri më tani ka pasur marrëdhënie shumë të mira me PE-në dhe me shumë parlamente të vendeve anëtare të BE-së, ndërkaq ka shtuar se marrëdhënie të mira bilaterale janë vënë edhe me parlamentet e vendeve të dala nga ish-Jugosllavia, pos me Serbinë dhe Bosnje e Hercegovinën, të cilat vazhdojnë të mos e njohin pavarësinë e Kosovës, kurse Beogradi zyrtar madje e ka instrumentalizuar një numër të qytetarëve serbë të Kosovës dhe po e pengon stabilizimin e gjendjes në veri të vendit tonë.

Duke folur për angazhimet e Kosovës për krijimin e raporteve të mira me qytetarët serbë të Kosovës dhe angazhimin serioz të institucioneve të Kosovës për të realizuar standardet më të larta evropiane për të drejtat e komuniteteve pakicë, Krasniqi ka theksuar se pala kosovare ka qenë konstruktive edhe në dialogun teknik me Serbinë, ndërkaq pala serbe nuk po tregon gatishmërinë për t'i përmbushur marrëveshjet e arritura gjatë procesit të dialogut në Bruksel.

Dy ish-presidentët e Shqipërisë, në Kuvendin e Kosovës



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim dy ish-presidentët e Shqipërisë, z. Alfred Moisiu dhe z. Rexhep Meidani.

Temë thelbësore e këtij takimi ishin zhvillimet aktuale në Kosovë, sidomos pas dhënies së dritës së gjelbër për studimin e fizibilitetit të Kosovës nga ana e Komisionit Evropian. Këto procese, u theksua, nëpër të cilat po kalon Kosova, është e rëndësishme që të kryejë detyrat e saj, që do të kontribuojnë drejt integriteteve evropiane. Në këtë vështrim është me peshë fakti, që Kosovën e kanë njohur një numër i madhe vendesh, por në këtë aspekt mund dhe duhet të bëhet edhe më shumë, që procesi i njohjeve të ecë edhe më tutje, duke ditur efektet shumë të mira që kanë njohjet. Në këto procese, u tha se bashkëpunimi me Shqipërinë duhet të thellohet edhe më tej, sepse ajo ka resurse e mundësi për të bërë më shumë në afirmimin e pavarësisë së Kosovës dhe nevojës së njohjes së saj sa më gjerë në botë, si një realitet.

Gjatë këtij takimi kryekuvendari i njohu ish-presidentët e Shqipërisë edhe me punën që po bëhet në Kosovë lidhur me reformën zgjedhore dhe kushtetuese.

Përfaqësuesi i Bankës Botërore, Olters:

“Do të mbështesim projektet për strategjinë energjetike në Kosovë”



Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, Dr. Jakup Krasniqi, priti në një takim përfaqësuesin e Bankës Botërore, Jane Peter Olters, nga i cili është njoftuar për strategjinë energjetike për katër vitet e ardhshme të Bankës Botërore dhe për vizitën që do ta ketë gjatë muajit mars në Kosovë, zv.drejtori i Bankës Botërore, Philippe Le Houerou, në kuadër të përgatitjes së marrëveshjes për mbështetjen e projekteve energjetike të vendit tonë.

Olters ka pohuar interesimin e Bankës Botërore për mbështetjen e projekteve energjetike në Kosovë mbi bazën e linjitet, të cilat sipas ekspertëve të kësaj banke, nuk janë në kundërshtim me parimet bazë kundër ngrohjes globale.

Kryeparlamentari Krasniqi e ka vlerësuar të rëndësishme për Kosovën vizitën e z. Philippe Le Houerou, dhe ka përshëndetur përkushtimin e Bankës Botërore për t'i mbështetur, në formë subvencionesh, projektet energjetike në Kosovë.

Bashkëbiseduesit në këtë takim janë pajtuar se gjatë vizitës në Kosovë z. Le Houerou të ketë takim edhe me përfaqësuesit e të gjitha partive parlamentare në Kuvendin e Kosovës, me qëllim që të sqarohen politikat e Bankës Botërore dhe prioritetet e këtyre partive, si parakusht për një ratifikim të suksesshëm të marrëveshjes eventuale ndërmjet Kosovës dhe Bankës Botërore.

Përfaqësuesi i FMN-së, Wiegand: “Përshpejtoni ligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe atë për bankat”



Përfaqësuesi i FMN-së e njoftoi kryetarin e Kuvendit lidhur me bisedimet që po zhvillohen me Qeverinë e Kosovës për programin “Stand by”, arritja e të cilin kërkon miratimin e dy ligjeve në Kuvend

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës, dr. Jakup Krasniqi, priti në takim përfaqësuesin e Fondit Monetar Ndërkombëtar (FMN), Johannes Wiegand. Përfaqësuesi i FMN-së e njoftoi kryetarin e Kuvendit lidhur me bisedimet që po zhvillohen me Qeverinë e Kosovës për programin “Stand by”, duke potencuar ecurinë pozitive të këtyre bisedimeve. Ai tha se miratimi i këtij Programi në muajin prill, kërkon paraprakisht miratimin e dy ligjeve nga ana e Kuvendit: Ligjin për fondet pensionale të Kosovës dhe atë për bankat.

Kryeparlamentari Krasniqi shtroi nevojën e vazhdimit të mbikëqyrjes financiare për Kosovën nga ana e FMN-në dhe të bashkëpunimit me mekanizmat e tjerë financiarë ndërkombëtarë. Në këtë vështrim, kryetari i Kuvendit theksoi se të dy projektligjet janë në procedurë dhe shfaqti besimin se ato do të miratohen në Kuvend në një afat sa më të shpejtë.

Krasniqi dha një pasqyrë të miratimit të ligjeve në Kuvend, duke veçuar mbikëqyrjen që u bëhet atyre gjatë shqyrtimit nëpër komisione, për të parë nëse implikimet financiare të tyre janë në përputhje me planifikimet buxhetore. Në këtë takim ishte i pranishëm edhe ministri i Financave, Bedri Hamza.

“ Ky shekull vlerësohet si periudha e ndryshimeve dhe e mundësive të mëdha... Avancimi i rolit të gruas, në rrjedhat e përgjithshme të shoqërisë në këtë periudhë të rëndësishme të funksionimit të Republikës së Kosovës shtet, mbetet prioritet që barazia gjinore të sendërtohet sipas parimeve më të larta evropiane”.

Dr. Jakup Krasniqi

Gëzuar 8 Marsin





Vizitë e studenteve të UP, Fakulteti Juridik në Kuvend